**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional**

**në "Informatikë e Aplikuar", me profile:**

*a) Dizenjim dhe zhvillim aplikimesh;*

*b) Menaxhim të dhënash;*

*c) Siguria e sistemeve të informacionit;*

*d) TV-Multimedia;*

*e) Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh*

**"Universiteti Europian i Tiranës"**


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Edlira Martiri

Dr. Miranda Harizaj


Mars / 2020

**TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË INFORMATIKË E ZBATUAR", ME 5 PROFILE, NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

Nga verifikimi i dokumenteve, ky program studimi është licencuar fillimisht si MP në "Informatikë e Aplikuar" me profile: a. Dezinjim dhe Zhvillim Aplikimesh; b. Bazë të Dhënash; c. Informatikë Sociale, me Urdhër Nr. 408, datë 22.08.2011 të MASH, bazuar në Vendimin Nr.210, datë 2011-07-29 të Këshillit të Akredititmit "*Për hapjen e programeve të studimit*".

Ky program është akredituar me Urdhër Nr.251, datë 2013-06-14 të MASH "Për akreditimin e disa programeve të studimit Bsc, Msc dhe MP pranë Universitetit Europian të Tiranës", bazuar në vendimin m. 467, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit (ky vendim ka pasur disa rekomandime).

Programi i studimit është riorganizuar me Vendim Senati, nr.7. Prot, date 14.06.2018, dhe miratuar nga MASR me shkresën 8244/2 prot, datë 12.09.2018, për ndryshimet deri në masën 20%. Ky riorganizim ka ndryshuar emërtimet dhe numrin e profileve dhe ka marrë emërtimin Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me profile: a. Dezinjim dhe Zhvillim Aplikimesh, b. Menaxhim të dhënash, c. Siguria e Sistemeve të Informacionit, d. TV - Multimedia, e. Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh, (më tej do citohet program Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile).

Njësia Kryesore është Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës.

Njësia Bazë, përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.

Ky raport bën vlerësimin e jashtëm në kuadër të riakreditimit të programit.

UET. Kjo lidhet dhe me natyrën e formimit që duhet të kenë studentët e diplomuar në këtë program. Por, GVJ sugjeron që pjesa e thellimit në veprimtarinë kërkimore-shkencore është esenciale për cdo student të ciklit të dytë të studimeve.

4. **Adoptimin e filozofisë së të mësuarit nëpërmjet pjesëmarrjes në punë kërkimore**

**GVJ mendon se:** Ky rekomandim nuk është përmbushur nga IAL. IAL ka arritur deri diku të adoptojë filozofinë e të mësuarit nëpërmjet pjesëmarrjes në punë kërkimore. Ne vërejmë një përpjekje mjaft të mirë të IAL në përfshirjen e studentëve në tregun e punës, apo në orientimin e tyre drejt aktiviteteve apo detyrave me natyrë profesionale. Por, sërish theksojmë nevojën dhe rëndësinë e krijimit të kushteve lehtësuese për studentët në kryerjen e hulumtimeve, si p.sh. kryerjen e matjeve dhe informatizimit të proceseve të ndryshme të biznesit, nxjerrjen e konkluzioneve nëpërmjet anketimeve për indikatorë, faktorë, pyetje shkencore të natyrave të ndryshme, dhe analizimin e të dhënave, apo dhe ndjekjen e metodave të tjera shkencore e të aplikueshme në Informatikë. Kjo është një përpjekje që duhet realizuar ngushtësisht në bashkëpunim me personelin akademik me kohë të plotë të departamentit përkatës, si dhe në funksion të fushave të interesit kërkimor të këtij personeli.

5. **Pasurimin e bibliotekës me botime të jashtme për zbatimin e projekteve kërkimore.**

**GVJ mendon se**: Ky rekomandim është përmbushur nga IAL. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe peronelit akademik një bibliotekë të pasur e të plotësuar me botime të fushave të ndryshme. IAL gjithashtu ofron gjetjen e burimeve online, nëpërmjet regjistrimit në botues të ndryshëm si Questia, Social Science Library, Sage. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). Të gjitha këto zgjerojnë edhe me tepër diapazonin e titujve dhe autorëve të vënë në dispozicion. Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjutera për kërkime, si dhe e gjithë sipërfaqja lejon aksesimin në rrjet.

6. **Sigurimin e mbështetjes nga burime te jashtme per zbatimin e projekteve kerkimore.**
7. **Të krijohen mundësitë për të patur akses më të lartë në financimet e BE-së**

**GVJ mendon se**: Keto rekomandime janë përmbushur nga IAL. Përfshirja në projekte ndërkombëtare është një nga arritjet kryesore të IAL në drejtim të zhvillimit akademik, mobilitetit, rrjetëzimit me institucione homologe, etj., faktorë këto tejet të rëndësishëm në jetën universitare të akademikëve dhe studentëve. Bazuar në të dhënat dhe deklarimet e IAL, konstatojmë që Universiteti Europian i Tiranës, si pjesë e programeve Kërkim dhe Zhvillim të Bashkimit Europian dhe donatorëve të tjerë rajonaë apo lokalë, menaxhon fonde të konsiderueshme financiare. Kështu, UET menaxhon një projekt Erasmus + CBHE (E-VIVA), me një bashkim prej 16 partneresh, për periudhe 3 vjecare, të akorduar nga BE, merr pjesë në programin Erasmus + KA1 Shkëmbim personeli dhe studentwsh (për periudhën 2015- 2018 UET ka derguar rreth 210 studentë nëuniversitetet partnere ne Europe), ka marreveshje per diploma te perbashketa (POSIG) dhe te dyfishta (South Carolina Upstate University - USA; South Bank London University – UK; Mälardalen University – Suedi), ka perfituar një infrastrukture në pajise (hardware/ software/ libra/ biblioteka online) për vitet 2016-2019 të financuar nga fondet e BE.

8. **Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.**

**GVJ mendon se:** UET zbaton parashikimet ligjore lidhur me mbrojtjen e gjuhëve të huaja.

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

### Përshkrim përmbledhës

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar me Urdhrin e ASCAL Nr.83, Datë 16.10.2019 "Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universitetit Europian i Tiranës" dhe në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti Europian të Tiranës, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", në 5 profile e përbërë nga 124 dokumenta në total. Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", në 5 profile, kanë realizuar vizitat në datat 19 dhe 20 Nëntor 2019, në Institucionin e Arsimit të Lartë "Universiteti Europian të Tiranës", sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Ekspertët vlerësuan edhe dokumentacionin e kërkuar gjatë vlerësimit.

Grupi i ekpertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kritereve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Europian i Tiranës".

Koordinator Teknik i vlerësimit të këtij programi ka qenë specialisti i ASCAL ME. Renata Qatipi.

Koordinator Teknik i vlerësimit të këtij programi ka qenë specialisti i ASCAL ME. Renata Qatipi

Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm u bë për shkak të kushteve të jashtëzakonshme pas tërmetit të 26 Nëntorit ( UET dhe ekspertët patën pengesa për tu angazhuar sipas parashikimit).

Më datë 27.02.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 9/26 Prot., datë 27.02.2020 "*Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm*", Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UET përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft–Raportin, me shkresë Nr. 06/19 Prot., datë 04.03.2020 "*Përgjigje për draft Raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të Ciklit të dytë Master Profesional në Informatikë e Aplikuar , me 5 profile*". Në këtë dokument institucioni ka disa komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet e UET sqaron si më poshtë:

1. **Paragrafi në draft RVJ**

| |
|---|
| ***Standardi I.3***<br>*Në Masterin Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile mund të pranohen studentë, të cilët kanë përfunduar një diplomë të nivelit të parë (pika 2.1), pra në këtë cikël mund të regjistrohen studentë nga cdo program bachelor. Në këtë aspekt, duke qenë se aftësitë teknike të ofruara në këtë program kërkojnë një formim bazik paraprak, mendojmë që përmbajtja e programit të studimit duhet të konsiderojë edhe këtë fenomen, gjë që sjell krijimin e heterogjeniteti brenda grupeve mësimore.* |

**Komenti i UET:**

Meqënëse programi është më shumë teknik çdo individ i interesuar për t'u specializuar në këto profile ka të drejtën e ndjekjes së studimeve. Studenti në momentin e regjistrimit njihet me programin dhe është i vetëdijshëm për aftësitë dhe punën që i duhet të kryejë. Vetë legjislacioni për arsimin e lartë nuk e ka gjykuar të arsyeshme të vendosë kufizime të lidhura me fushën e mëparshme të studimit, sa i takon programeve të ciklit të dytë. Gjithsesi personeli akademik i UET është gjithmonë i gatshëm të ofrojë konsultime jashtë orës së mësimit, për studentë që kanë vështirësi në kuptimin apo përvetësimin e materialeve, duke e orientuar studentin edhe të konsultojë literaturën hyrëse që e ndihmon për të plotësuar boshllëqet që mund të ketë nga studimet e ciklit të parë. Studenti ka mundësi të përtvetësojë lëndën bazuar dhe te orët e punës individuale, të vlerësuara pozitivisht nga GVJ. Deri më sot, nuk kemi pasur kërkesë nga ana e studentëve për të ofruar kurse plotësuese jashtë kurrikulës së programit.

**GVJ:** Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UET. Vlerëisimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar

2. **Paragrafi në draft RVJ**

| **Standardi I.4** |
| --- |
| *Kriteri 1 GVJ sheh si mjaft të rëndësishme shtimin e burimeve njerëzore si dhe rritjen e kapaciteteve në drejtim të lëndëve teknike të programit master, për të rritur dhe cilësinë e diplomës në përgjithësi.* |

**Komenti i UET:**

Biem dakord me konstatimin e GVJ. Rritja e cilësisë së burimeve njërëzore të angazhuara në mësimdhënie në fushën e IT është një nga çështjet ku Departamenti ka hasur vështirësi për t'i plotësuar në përputhje me standardet e cilësisë. Kjo nisur nga fakti se zakonisht të diplomuarit në këtë fushë priren drejt profesionit dhe jo kualifkimit të mëtejshëm akademik. Për më tepër, për shkak të pagave të larta që aplikohen në tregun e punës për pozicione pune të lidhura me profesionin e IT, është shumë e vështirë që ekspertët e kësaj fushe të shfaqin interes për t'u angazhuar full time në një IAL, duke lënë kështu në plan të dytë profesionin e tyre. Shpresojmë që këto specifika të kësaj fushë studimi të mbahen në konsideratë në gjykimin e përgjithshëm të përmbushjes së standardeve nga ana e GVJ.

**GVJ:** Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UET. Vlerëisimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar

3. **Paragrafi në draft RVJ**

| ***Standardi I.4*** |
| --- |
| *Kriteri 3 Ky harmonizim besojmë se vjen si pasojë e historikut të shkuar të strukturave institucionale (pjesa e Fakultetit të Ekonomisë), por vlerësojmë që në vijim të ketë më tepër pavarësi nga departamentet e tjera, në mënyrë që programet të jenë më të linjëzuara brenda secilit profil. Për ta ilustruar, konsiderojmë profilin "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh". Një student i këtij programi zhvillon disa lëndë bazë dhe karakterizuese me profil të mirëfilltë teknik (MIS, rrjeta kompjuterike, kërkime operacionale), dhe pjesën tjetër me lëndë formuese të fushës së menaxhimit të projekteve me profil ekonomik. Gjithsesi, departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, i cili është përgjegjës për këtë program studimi, siguron përputhje mes disiplinave të ndryshme.* |

**Komenti i UET:**

Në fakt, ofrimi i profileve ndërdisiplinore brenda programeve të studimit është rrjedhojë e filozofisë së hartimit të kurrikulave në UET, e cila nuk prek vetëm programin e studimit MP Informatikë e Aplikuar, por reflektohet në gjithë programet e studimit që UET ofron. Me përshtatjen që iu bë programeve të studimit përpara fillimit të vitit akademik 2018-2019, UET synoi pikërisht të zgjeronte mundësitë e profilizimit të orfuara brenda programeve të studimit, jo vetëm me profile të fushës përkatëse, por edhe me profile ndërdisiplinore, të cilat lidhen me profile pune specifike. Në rastin e programit MP Informatikë e aplikuar, profili "Menaxhim dhe vlerësim projektesh" i përket pikërisht kësaj kategorie profilizimesh. Studenti pajiset me njohuri teorike dhe praktike për menaxhimin dhe vlerësimin e projekteve, të cilat mund t'i implementojë për sistemet e informacionit. Ky profil mbështet, jep aftësi dhe stimulon studentët të ndërmarrin sipërmarrje individuale pas studimeve.

**GVJ:** Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UET. Vlerëisimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar

4. **Paragrafi në draft RVJ**

| |
|---|
| ***Standardi II.1***<br>*Kriteri 2: GVJ vëren se ka nje mosperputhje p.sh. mes listës së pozicioneve të punës të ofruar si më lart në Rregulloren Mësimore të Programit, dhe përmbajtjes së ndodhur në Suplementi i diplomes, pika 5.2.* |

**Komenti i UET:**

Konstatimi i mospërputhjes nga ana e GVJ qendron. Sqarojmë se kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së përditësimit të Aneksit të Rregullores mësimore të programit të studimit, ndërkohë që suplementi është përditësuar. Departamenti do të marrë masat për të reflektuar mbi konstatimin e saktë të GVJ dhe do të bëjë përditësimet e nevojshme.

**GVJ:** Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UET. Vlerëisimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar

5. **Paragrafi në draft RVJ**

| |
|---|
| ***Standardi II.1***<br>*Kriteri 3: GVJ konstaton një përpjekje mjaft të mirë të IAL në përfshirjen e studentëve në tregun e punës, apo në orientimin e tyre drejt aktiviteteve apo detyrave me natyrë profesionale. Por, programi i studimit sugjerohet të krijojë kushte lehtësuese për studentët në kryerjen e hulumtimeve, si dhe ndjekjen e metodave shkencore e të aplikueshme në Informatikë.* |

**Komenti i UET:**

Mendojmë se programi krijon kushtet e duhura lehtësuese për hulumtim, për aq sa i përket llojit të tij si program Master Profesional. Duke qenë se ky program nuk synon t'i japë akses studentit në studimet e doktoratës, por ta pajisë atë me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme

profesionale për tregun e punës, theksi është vënë tek njohuritë aplikative dhe praktike. Edhe punimi i diplomës është konceptuar si projekt aplikativ, ku synohet që studentët të kryejnë hulumtime në fushën profesionale.

**GVJ:** Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UET. Vlerëisimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar

## 6. Paragrafi në draft RVJ

***Standardi II.4***

*Kriteri 2: Kështu p.sh. GVJ sugjeron që:*

1. *në emërtimet e lëndëve të hiqen termat "E avancuar"; lënda "Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit" qe vjen nga Management Information Systems, duhet të emërtohet si "Sistemet e Informacionit të Menaxhimit".*
2. *Në brendësi të programeve lëndore të detajohen pjesët praktike në mënyrë më konkrete.*
3. *Lëndët të mos jenë bashkim i dy disiplinave apo moduleve, pasi rrezikohet që dija në to të jepet në mënyrë sipërfaqësore (p.sh. Kriptografi dhe Ethical Hacking, apo Menaxhim dhe Vlerësim, etj.)*
4. *Lëndët në përgjithësi kanë nevojë për një rishikim të përmbajtjes së tyre në mënyrë që të eliminohen përsëritjet, të jenë të linjëzuara në të gjithë planin e programit mësimor, si dhe të zgjidhen në mënyrë të tillë, që të jenë saktësisht thelbi i secilit prej profileve. P.sh. lënda Menaxhimi i riskut në IT, shihet më shumë si lëndë e mirëfilltë Siguri Informacioni ose Sistemesh Kompjuterike; lënda "Aplikimi i Sistemeve të Informacionit" është në përmbajtjen e saj "Inxhinjerim softesh" e për pasojë GVJ sugjeron riemërtimin e saj; lënda Zhvillim i avancuar i softuerëve është në përmbajtjen e saj vetëm "Programim në platformat mobile".*

**Komenti i UET:**

Në lidhje me pikën 1, sqarojmë se termi "i avancuar" është përdorur për të diferencuar lëndët e ciklit të dytë, nga lënda hyrëse që zhvillohet në ciklin e parë të studimeve. Sa i përket lëndës "Menaxhim i sistemeve të informacionit" nëse do të titullohet siç është propozuar nga GVJ "Sistemet e informacionit të Menaxhimit", nuk do të reflektonte saktë përmbajtjen e saj, pasi lënda trajton jo vetëm sistemet menaxheriale, por edhe të gjitha sistemet e informacionit dhe si menaxhohen këto sisteme.

Departamenti do të marrë masat e nevojshme për të reflektuar sygjerimet e dhëna nga GVJ, në pikën 2 gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020.

Sa i takon bashkimit të dy disiplinave apo moduleve në të njëjtën lëndë (pika 3) është gjykuar që studenti i një programi të ciklit të dytë është në gjendje të përvetësojë në mënyrë më intensive dhe të pavarur një volum më të madh informacioni e njohurish, dhe ky bashkim nuk shihet se mund të shkaktojë probleme për përvetësimin e lëndës nga studentët, përkundrazi i pajis ata me të gjitha njohuritë e nevojshme, në harkun kohor të shkurtër të një viti akademik. Gjithsesi, Departamenti do të reflektojë mbi sugjerimin e GVJ.

Falenderojmë ekspertet për rekomandimet konkrete të parashtruara në pikën 4. Dëshirojmë të nënvizojmë se ndonëse disa koncepte mund të trajtohen në dy ose më shumë lëndë, mënyra e trajtimit të tyre i shërben programit specifik të lëndës. Është e pamundur të evitohet rimarrja e koncepteve themelorë, brenda fushës së studimit. Megjithatë, jemi të ndërgjegjshëm që gjithmonë ka vend për përmirësim dhe sugjerimet e paraqitura janë një orientim i mirë për të përmirësuar cilësinë e syllabuseve.

**GVJ:** Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UET. Vlerëisimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar

7. **Paragrafi në draft RVJ**

| |
|---|
| ***Standardi II.4*** <br> *Kriteri 6 GVJ konstaton që:* <br> *1. Literatura e cituar nën seksionet: a. Literatura bazë e detyrueshme, dhe b. Literatura e rekomanduar, nuk ndjek në mënyrë konsistente të njëjtin standard referimi (p.sh. APA style, apo të tjerë).* <br> *2. Në këto bibliografi, në pjesën më të madhe të tyre, mungon vendosja e vitit të botimit (i detyrueshëm në cdo standard). Për pasojë, nuk mund të themi kohën e botimit të tyre.* <br> *3. Një pjesë e lëndëve i kanë vitet të shprehura në literaturat e lëndëve, por këto janë mbi 5 vite të vjetra, pra më herët se 2015..* |

**Komenti i UET:**

Departamenti do të marrë masat për të pasqyruar sugjerimet dhe vërejtjet për literaturën dhe bibliografinë që në syllabuset që do të miratohen për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020.

**GVJ:** Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UET. Vlerëisimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar

8. **Paragrafi në draft RVJ**

| |
|---|
| ***Standardi II.4*** <br> *Kriteri 7: GVJ sugjeron rritjen dhe përmirësimin e anës praktike të secilës lëndë të profilit, si dhe një përqasje tjetër në kriteret e pranimit të studentëve në programin master profesional të kësaj natyre, sic është shprehur dhe në kriteret e mësipërme.* |

**Komenti i UET:**

Programi përmban 120 orë praktikë profesionale në një institucion, kompani të lidhur me fushën e programit. Për aq sa mund të ofrojë një program me 60 ECTS, me kohëzgjatje 1 vit akademik, nuk mund të themi se praktika është e pamjaftueshme. Për më tepër mësimi kryhet në laboratorë dhe studentët kanë mundësi për përvetësimin e kompetencave praktike që ofron secila prej lëndëve. Kjo duket dhe nga komenti per standartin III.8. Sa i takon kritereve të pranimit në këtë program, ato janë janë në përputhje të plotë me Ligjin për Arsimit të Lartë, dhe UET në filozofinë e tij nuk ka për synim të kufizojë mundësitë e studimit për asnjë kategori studentësh. Të gjithë studentëve duhet t'u ofrohet mundësia për të studiuar, sipas preferencave të tyre, brenda hapësirave që njeh ligji. Detyra e institucionit është të hartojë programe studimi në përputhje me standardet e cilësisë dhe kërkesat e tregut të punës, dhe të ofrojë kushte sa më optimale për ndjekjen e këtyre studimeve nga studentët.

**GVJ:** Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UET. Vlerëisimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar

## 9. Paragrafi në draft RVJ

| |
|---|
| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit.**<br>*Shkalla e përmbushjes së standardit:* ***Përmbushet kryesisht*** |

**Komenti i UET:**

Në evidencat e renditura nga GVJ nuk paraqitet asnjë problematikë e konstatuar, që të justifikojë vlerësimin e përcaktuar në fund për këtë standard.

**Pergjigja GVJ.**

Ne **kriterin 1** të këtij standardi cilësohet: Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.GVJ konstatoi se nga institucioni janë paraqitur në nivel institucioni, statistikat e personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile."

Megjithatë vlerësimi i Standardit IV1 ndryshon në **përmbushet plotësisht,** duke sqaruar se **GVJ është përgjigjur saktësisht për kriterin, por ndryshon vlerësimin duke pasur besim se në të ardhmen të dhenat do mbahen më të detajuara edhe në nivel programi.**

## 10. Paragrafi në draft RVJ

| |
|---|
| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**<br>*Shkalla e përmbushjes së standardit:* ***Përmbushet kryesisht*** |

**Komenti i UET:**

Nuk ka asnjë koment negativ apo sugjerim për të gjitha kriteret e këtij standarti që të mund të justifikojë vlerësimin përfundimar të përcaktuar Kryesisht.

**Pergjigja GVJ.**

GVJ ka pohuar se nuk janë hartuar dhe publikuar kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në këtë program studimi. Kriteret e përgjithshme për pranimin janë publikuar në faqen zyrtare të ëeb të UET dhe u është komunikuar para fillimit të vitit akademik studentëve dhe të interesuarve në zyrat përkatëse të institucionit." Por duke reflektuar kërkesat e kritereve përkatëse 3 dhe 4 GVJ mendon se duhen hartuar kritere të vecanta për pranimin e studentëve në këtë program studimi, për secilin profil (mund te jene te ndryshme). Kjo në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit master, me vlerën e diplomës që synohet, si dhe me kërkesat e tregut.

## 11. Paragrafi në draft RVJ

| |
|---|
| ***Standardi V.2***<br>*Kriteri 4 Në takimin me studentët u informuam që në vitin akademik 2018-2019 është vendosur në mes të vitit kriteri penalizues i mesatares së studimeve Bachelor për zgjedhjen e punimit të diplomës, për të cilën studentët duhet të ishin informuar para fillimit të studimeve.* |

**Sqarimi UET:** Është e vërtetë që paketa për mbrojtjen e punimit të diplomës u finalizua pasi viti akademik kishte nisur. Megjithatë të gjithë studentëve të cilët nuk plotësonin kriterin e notës mesatare për të aplikuar për projekt aplikativ, por kishin dëshirë të mbronin diplomën përmes projektit dhe jo provimit, iu miratua kërkesa për të vijuar me zhvillimin e projektit, pikërisht për arsye se kriteri nuk ishte komunikuar që në fillim të vitit akademik. Kështu garantojmë se UET nuk ka ceduar në asnjë rast në respektimin e të drejtave të studentëve. Vendimi që studentët e programeve MP kanë të drejtë të vijojnë me mbrojtjen e diplomës përmes punimit të diplomës u është bërë i ditur gjithë departamenteve, të cilët kanë miratuar çdo kërkesë të paraqitur nga studentët.
Mbështetur në sa më sipër, mendojmë se GVJ mund të rishikojë vlerësimin e përgjithshëm për këtë standard, për sa kohë nuk evidentohet ndonjë problematikë tjetër, përveç informacionit të pasaktë të marrë gjatë takimit me studentët.

**Pergjigja GVJ.**

Informacioni per vendosjen e kriterit penalizues te mesatares se studimeve Bachelor, ne mes te vitit u konfirmua dhe u paraqit si shqetësim në takim nga disa studentë dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet i pasaktë. IAL duhet te percaktonte dhe te informonte studentet mbi kriteret dhe procedurat para fillimit te studimeve. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UET. Vlerëisimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar

| |
|---|
| **Vlerësimi i përgjithshëm është përcaktuar Përmbushen Kryesisht, ndonëse vetëm 2 nga 6 fushat kanë vlerësim përfundimtar të tillë.** |

**Komenti i UET:**

Nuk dimë nëse vetë ASCAL ka një orientim për ekspertët se si konvertohet vlerësimi sipas fushave në vlerësim tërësor për programin e studimit, por matematikisht, vlerësimi tërësor nuk është normale të jetë më i ulët se mesatarja e vlerësimeve sipas fushave.

**GVJ**: Në lidhje me vlerësimin e përgjithshëm të ketij Raporti, ne jemi të mendimit që ***Kryesisht*** është vlerësim i bazuar në një analizë cilësore dhe jo sasiore të rezultateve të standarteve e kritereve të vecanta. Më konkretisht, Standarti 1 dhe 2 janë përcaktues për një program studimi, për pasojë kanë peshë më të madhe; probleme janë evidentuar dhe në Standardet 3 dhe 4, por një pjesë e kritereve të këtyre standardeve janë trajtuar nga GVJ në një formë më të përgjithshme, duke pasur parasysh vështirësitë që kanë të gjitha IAL me burimet njerëzore në këto lloj shkencash, pra nuk i kemi parë si mangësi direkte të IAL, por të realitetit tonë.

Në këtë përgjigje, sikurse pohohet në fillim të tij, IAL ka paraqitur sqarime dhe komente për vetëm disa nga sugjerimet dhe vërejtjet tona. Konsiderojmë që ka dhe cështje të tjera të rëndësishme në RVJ, të cilat IAL duhet të adresojë, të cilat janë shprehur në listën e RVJ në formën e 13 Rekomandimeve dhe 16 Pikave të Dobëta. Për këto arsye, i qëndrojmë vlerësimit tonë të përgjithshëm si ***Kryesisht***, duke e konsideruar një vlerësim mjaft të mirë dhe të pranueshëm për këtë program studimi, me mirëbesimin se këto vërejtje e rekomandime do të reflektohen nga IAL në të ardhmen.

Për ta përmbyllur, GVJ falenderon IAL për punën mjaft të mirë në lidhje me kujdesin ndaj studentëve dhe shfaqjes së tyre në tregun e punës, dokumentacionit mësimor, kontrollit të cilësisë, angazhimit në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe në mbajtjen aktive të komunitetit të alumnit të tyre, arrijte këto që do të donim t'i shihnim të realizuara dhe në IAL të tjera në përgjithësi, apo në degët e Teknologjisë së Informacionit në vecanti.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile

## I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

| Standardi I.1<br>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master profesional" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | GVJ arrin në përfundimin se programi Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar", *me profile: a) Dizenjim dhe zhvillim aplikimesh; b) Menaxhim të dhënash; c) Siguria e sistemeve të informacionit; d) TV-Multimedia; e) Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh*, (më tej me 5 profile) i ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës, është në përputhje dhe në harmoni me interesat kombëtare. Kjo është e shprehur dhe në "Planin Strategjik 2015-2020", ku IAL synon të ndjekë modelin sipas të cilit arsimi ka rol parësor në përmirësimin e përgjithshëm të një vendi.<br><br>Programi Master Profesional në fjalë, duke qenë se ndjek strategjinë dhe vizionin e përgjithshëm të UET, në bazë të Planit Strategjik të tyre, ka synim të zhvillojë dhe të ketë prioritare kërkimin shkencor në aktivitetet e përditshme të tij, si dhe të shmangë praktikat e gabuara. Këtë vizion e shohim të detajuar dhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2017-2020. Sipas këtyre dokumenteve GVJ sheh dhe prioritetet e tjera në aspektin mësimor, atë të botimeve, si dhe në zhvillimin e aktiviteteve social-kulturore.<br><br>**Plani Strategjik 2015 – 2020.pdf, Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.pdf** |
| **Kriteri 3** Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Në bazë të Planit Strategjik për zhvillimin e programit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile GVJ konstaton që hapja e këtij programi përmbush objektivat strategjike institucionale. Ky program mbështetej më parë nga Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Me ndryshimet strukturore të kësaj IAL programi Master Profesional u bë pjesë e Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, njësi bazë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, i hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 529, datë 04.09.2018, gjë që tregon për GVJ një zhvendosje më të përshtatshme të programit të ofruar dhe përputhje më të mirë në fushën e veprimtarisë.<br><br>**Plani Strategjik 2015 – 2020.pdf; URDHER Nr.529, date 04.09.2018, Hapjen e njesise kryesore Fakulteti i Inxhinierise.pdf** |
| **Kriteri 4** Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Në bazë të Raportiti të Vlerësimit të Brendshëm të IAL, konstatohet që programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe ka si objektiv të plotësojë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Kjo shihet dhe në projektin institucional 500+ (më parë 250+), që përfshin kompanitë më të mëdha në vend. Ky projekt, i cili ka si qëllim bashkëpunimin e biznesit me akademinë, ka arritur që të |

| | |
|---|---|
| | integrojë dhe studetë në internshipe apo punësime. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh në mënyrë më të detajuar me projektin, mënyrën e zhvillimit të aktiviteteve të tij, periodicitetin e tyre, si dhe impakti që ka pasur në ngritjen institucionale.<br><br>**Projekti 250+.pdf** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Në bazë të dokumentave të IAL si Plani Strategjik per zhvillimin e programit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile, Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, si dhe RVB, GVJ arrin në përfundimin se programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të IAL. Gjithashtu kjo evidentohet edhe ne dokumentin Plani Strategjik 2015-2020 (Seksioni 1, pika 1.1), sipas të cilit: "*UET synon shndërrimin në një qendër ekspertize në fushën e ... teknologjisë së informacionit ...*".<br><br>**Rregullore e UET; Plani Strategjik 2015 – 2020** |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | GVJ konstaton se në disa dokumenta të rëndësishme të dorëzuara nga IAL (të sipërpërmendura) janë të shprehura qartë dhe në mënyrë të detajuar drejtimet prioritare akademike të tij. Në RVB institucioni shprehet se "*mbetet i hapur ndaj diversifikimit të ofertës së tij akademike e shkencore dhe në drejtime të tjera që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës*". Këtë e shohim të shprehur dhe në politikat e brendshme të IAL, sipas dokumentit "17. STUDIMI (periodik) PËR TREGUN E PUNËS, Programi i studimit Master Profesional në Informatikë e Aplikuar". Aspekti akademik dhe punësimi i studentëve të Masterit Profesional mendojmë se janë ndër objektivat e rëndësishme të IAL, të cilat përvec politikave të shkruara, GVJ i sheh se jetësuar dhe në aktivitetet universitare.<br><br>**RVB MP Informatike e Aplikuar; Studim periodik per tregun e punes** |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Drejtimi i Teknologjisë së Informacionit në përgjithësi në UET është ndër drejtimet e reja të ofruara nga ky IAL, krahasuar me degë të tjera të konsoliduara tashmë prej tij. Nga vetë natyra e kësaj disipline, GVJ mendon se programi i studimit të Masterit Profesional emërtohet, organizohet dhe ka strukturë të përputhur me drejtimet akademike të institucionit. Natyra e tij me profile është gjithashtu në kuadër të objektivave të IAL për të ofruara një strukturë unike në të gjitha drejtimet e tij (pra me profile të shumta). Mendojmë gjithashtu se struktura e përzgjedhur (master profesional një vjecar me 60 ECTS) është një mënyrë e mirë për të nxjerrë shpejt në treg specialistë të fushës (sipas Marrëveshjes së Bolonjës, të cilën e ndjek dhe IAL). GVJ sugjeron që |

| | |
|---|---|
| | përmbajtja e programeve me natyrë IT, të jetë në vëmendje të vazhdueshme nga IAL, për shkak të dinamikave të fushës. |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. | Shkencat kompjuterike në përgjithësi janë pjesë e strategjive kombëtare të zhvillimit si një nga fushat prioritare të tyre. Kjo është në përputhje me trendet globale të zhvillimit, madje mund të themi se Shqipëria ka ende mungesë për specialistë të këtyre fushave. Programi Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile, vihet re që ofron disa nga pozicionet e rëndësishme të këtyre specialistëve. GVJ mendon se këto profile kanë diversifikim të lartë dhe sugjerojmë ngushtimin e tyre në drejtime më të afërta teknike. Kjo do të lehtësonte dhe çështje të cilat lidhen me burimet njerëzore, me kapacitetet laboratorike, programet aplikative, etj. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.3**<br>**Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit "Master profesional" kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | Sipas përshkrimit të ofruar nga RVB, programi Master Profesional është hartuar dhe zbatohet në përputhje me qëllimin, misionin dhe objektivat e institucionit për të përgatitur specialistë të kualifikuar dhe të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut edhe në zhvillimin perspektiv të tij. Për këtë, në Rregulloren Mësimore të Programit, pika 3.3.2, shprehet që programi synon:<br>*a) të pajisë studentin me koncepte të aplikuara, të specializuara;*<br>*b) Përgatitje të lidhur ngushtë me profesionin e rregulluar ose licencën/at;*<br>*c) Formim nëpërmjet kurseve praktike, aplikative, laboratorëve;*<br>*d) Aftësi praktike aplikative në profesionin përkatës;*<br>*e) Njohuri teorike bazë të fushës së studimit;*<br>*f) Mundësi për stazh, internship të zgjeruar në operatorët kryesorë të tregut të punës; përfshirje në shoqatat profesionale, korporatat profesionale;*<br>*g) Aftësim për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës.*<br>*h) Diplomë të karakterit praktik, aplikativ, në formën e një studimi rasti, punë praktike ose produkt profesional.*<br>Këto objektiva shihet se janë konsideruar në mënyrë të detajuar nga strukturat e brendshme të IAL përgjegjëse. Këto struktura mbështesin vendimet e tyre dhe nga Bordi i Tregut te punes, i cili përbëhet nga alumni të UET. Por, GVJ konstaton mospërputhje të pjesëve të ndryshme përshkruese të objektivave dhe qëllimeve të programit master.<br>Për shembull, vihet re që në dokumentin "Suplementi i Diplomës", në |

| | |
|---|---|
| | pikën 4.2: "*Qëllimi i këtij programi është tu përgjigjet interesave të ndryshme që mund të kenë studentët dhe t'i bëjë ata të vetëdijshëm për rolin që do të luajnë në mbarim të tij në bizneset përkatëse ku punojnë. Studenti do të përvetsojë llogjikën e analizës së informacionit, strukturimin e tij në baza të dhënash, si dhe aplikime të ndryshme mbi këto baza të dhënash Qellimi kryesor i këtij Masteri është të ofrojë një kombinim të harmonizuar të dijeve praktike me ato teorike si edhe një formim të plotë për të filluar apo për të vazhduar një karrierë të suksesshme*".<br><br>Në RVB, grupi i punës shprehet që: "*Qëllimi i programit është formimi i profesionistëve të specializuar në fushën e informatikës, tejcimi përpara i njohurive në shkencat kompjuterike dhe aplikimet e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë në këto fusha. Ky program synon të formojë ekspertë dhe specialist cilësorë në aspektet teorike, dhe veçanërisht në aftësitë praktike aplikative në fushën e menaxhimit të bazës së të dhënave, teknologjisë së informacionit, dizenjimit dhe zhvillimit të aplikimeve dhe biznesit elektronik. Me lëndët që ky program ofron, studentët të cilët përfundojnë studimet pajisen me njohuritë e nevojshme për t'u angazhuar në biznese të llojeve të ndryshme, përfshirë ato projektuese, zbatuese, prodhuese dhe tregtare*".<br><br>Këto mund të jenë formulime të ndryshme, por të ngjashme. Ndërkohë, në Aneksin e Rregullores Mësimore të Programit të Studimit, lexojmë që këto qëllime e objektiva, bazuar në ndërtimin e strukturave mësimore për 5 profile në Masterin Profesional "Informatikë e Zbatuar", listohen profesionet e mundshme për punësim, të cilat nuk i shohim të përputhshme me qëllimet dhe objektivat e sipërmendura:<br><br>1. Personel IT, profili Programist Java<br><br>2. Personel IT, profili Baze te Dhenash<br><br>3. Personel IT, profili Menaxhim Rrjetash<br><br>GVJ mendon që IAL duhet të qartësojë: qëllimin, objektivat, strukturat mësimore, si dhe të vlerësojë diplomën në treg (punësimet e mundshme), bazuar në to.<br><br>**Rregullore mesimore_MP Informatike e Aplikuar; Suplementi i Diplomes; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm** |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve | Duke pasur parasysh nevojat mjaft imediate që ka tregu i punës në Shqipëri, bazuar në strategjitë kombëtare si dhe në kërkesat e vetë studentëve për profilet me natyrë informatike, hapja e programeve që plotësojnë këto kërkesa është e domosdoshme. Në UET, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe nga vizita e kryer nga GVJ, u konstatua që ky institucion realizon studime dhe aktivitete periodike me të diplomuarit (Alumni i UET) si dhe ka të ngritur Bordin e Tregut të punës. Një burim tjetër kualifikimi për studentët dhe stafin konstatuam që janë dhe projektet me partnerë të huaj, në të cilat është nxjerrë në pah se kush janë dhe nevojat e tregut ndërkombëtar në fushën e IT.<br><br>**[Studim periodik per tregun e punes], [Poster panairi i punes 2019], Te** |

| | |
|---|---|
| të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | **dhena per punesimin e studenteve], [Analizë vjetore e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimitMP]** |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Qëllimi për përgatitjen e studentëve me njohuri bazë aplikative shprehet në RVB, sipas të cilit misioni i programit është "të formojë specialistë me kompetenca të zgjeruara praktike në fushat e implementimeve të sistemeve informatike si dhe specialistë në lidhje me nevojat e teknologjisë së informacionit në sektorin publik apo privat". Në bazë të dokumentacionit, vecanërisht në Rregulloren Mësimore të Programit, në Masterin Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile mund të pranohen studentë, të cilët kanë përfunduar një diplomë të nivelit të parë (pika 2.1), pra në këtë cikël mund të regjistrohen studentë nga cdo program bachelor. Në këtë aspekt, duke qenë se aftësitë teknike të ofruara në këtë program kërkojnë një formim bazik paraprak, mendojmë që përmbajtja e programit të studimit duhet të konsiderojë edhe këtë fenomen, gjë që sjell krijimin e heterogjeniteti brenda grupeve mësimore. Si shembull, sjellim rastin e lëndës Zhvillimi i Avancuar i Softuerëve, programi i së cilës është mjaft i mirë dhe i përshtatshëm për studentë që kanë njohuri më parë në këtë lëndë.<br>**[Rregullore mesimore_MP Informatike e Aplikuar]** |
| **Kriteri 4.** Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.<br>**Kriteri 5.** Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. | Sipas RVB dhe konstatimit të GVJ programi i studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile është në përputhje me kriteret e Kartës të Bolonjës. Për hartimin e programit janë marrë parasysh programet e ofruara nga institucionet vendase dhe të huaja, por, sipas kriterit, IAL nevojit të saktësojë konkretisht se cilit programi të ngjashëm të ofruar nga institucione ndërkombëtare, ai i është referuar.<br>GVJ konstaton që ky program ofron gjithashtu një strukturë të programit mësimor të ndarë në disiplina mësimore dhe veprimtari të tjera formuese sipas kategorive nga A-E. Zgjedhja e ofrimit të një programi master me një periudhë kohore 1-vjecare e ndarë në dy semestra ndihmon në daljen herët në treg të të diplomuarve, gjë që është në përputhje dhe me praktikat e mira të vendeve europiane.<br>**[Programi_MP Informatike e Aplikuar]**<br>**Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar]** |
| **Kriteri 6.** Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Programi Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile, e përfshin në programin e tij të studimit një lëndë të mirëfilltë të dedikuar për praktikën profesionale, apo internshipin e studentëve pranë institucioneve të ndryshme publike dhe private (6 ECTS). Vlejnë për tu përshëndetur një numër i lartë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani të vendit, apo dhe projekte me partnerë ndërkombëtarë, por tek këto projekte shihet një përfshirje e ulët e pjesëmarrjes së studentëve në detyra konkrete, angazhime profesionale, apo shkencore.<br>**[Tabele Permbledhese te Praktikes Profesionale MP]** |
| **Kriteri 7.** Në varësi të profilit të | Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe nga RVB, |

| | |
|---|---|
| institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin. | GVJ konstaton që programi është i licensuar dhe zhvillohet në gjuhën shqipe. Gjithsesi, në politikat e IAL është e përfshirë dhe mundësia e zhvillimit të lëndëve specifike në gjuhë të huaj, si pasojë e shkëmbimeve të studentëve nga programet Erasmus+. |
| **Kriteri 8.** Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar. | Programi MP në "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, është hapur dhe zhvilluar edhe si pasojë e nevojave që ka tregu i punës vendas. Këta specialistë mund të pozicionohen në institucione të ndryshme publike e private dhe përthithja e tyre ndodh si pasojë e mungesës së burimeve njerëzore në përgjithësi në këto drejtime. GVJ është i mendimit që këto profesione do vazhdojnë të kërkohen dhe në të ardhmen e afërt, për pasojë, konsolidimi i programeve të studimit në ciklin e parë apo të dytë ne drejtimet e IT mbetet shumë i rëndësishëm. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi I.4**<br>**Programet e ciklit të dytë "Master profesional" janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Programi i studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile është ofruar fillimisht nga Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit. Pas ristrukturimit të institucionit, ky program studimi u ofrua nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Në bazë të dokumentacionit të kërkuar nga GVJ dhe të dorëzuar nga IAL, institucioni ka të angazhuar në këtë departament 10 lektorë, si personel efektiv, nga të cilët dy janë me titullin "Profesor", dy "Doktorë" dhe pjesa tjetër me "Master". Në department janë të angazhuar dhe 9 lektorë të ftuar.<br><br>GVJ sheh si mjaft të rëndësishme shtimin e burimeve njerëzore si dhe rritjen e kapaciteteve në drejtim të lëndëve teknike të programit master, për të rritur dhe cilësinë e diplomës në përgjithësi. Nga vizita në IAL, në takimin me dekanin, shefen e departamentit dhe stafin, u vu re dhe u pohua nevoja për plotësimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore, por këto mbeten sfida të cdo departamenti me drejtim IT.<br><br>**[Personeli akademik i departamentit 2019-2020]** |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas | GVJ konstaton që fusha e studimit të programit master profesional në "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore. Mendojmë që ristrukturimi i IAL dhe krijimi i fakultetit të ri me fokus inxhinierik, e ka kthyer vëmendjen e duhur dhe pozicionimin e këtij programi nën një njësi të përshtatshme.<br><br>Fushat e përgjithshme dhe speficike e programit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, konstatohet se është në |

| | |
|---|---|
| direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.<br><br>**Kriteri 3**. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. Edhe pse ky program ndërlidhet dhe me disiplina të tjera, pra nuk janë të gjithë profilet e tij drejtimet teknike në fushën e IT, shihet se pjesa tjetër plotësohet mjaft mire dhe nga lektorë të departamenteve të tjera, apo nga qëndra kërkimore. Ky harmonizim besojmë se vjen si pasojë e historikut të shkuar të strukturave institucionale (pjesa e Fakultetit të Ekonomisë), por vlerësojmë që në vijim të ketë më tepër pavarësi nga departamentet e tjera, në mënyrë që programet të jenë më të linjëzuara brenda secilit profil. Për ta ilustruar, konsiderojmë profilin "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh". Një student i këtij programi zhvillon disa lëndë bazë dhe karakterizuese me profil të mirëfilltë teknik (MIS, rrjeta kompjuterike, kërkime operacionale), dhe pjesën tjetër me lëndë formuese të fushës së menaxhimit të projekteve me profil ekonomik. Gjithsesi, departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, i cili është përgjegjës për këtë program studimi, siguron përputhje mes disiplinave të ndryshme.<br><br>**[Stafi akademik i programit MP Informatike e Aplikuar], Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik , MP Inf. Aplikuar** |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | GVJ konstaton se ky program nuk është jashtë profilit të institucionit, për pasojë ekspertiza në mbarëvajtjen e tij mbulohet nga vetë IAL. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion GVJ konstaton se programi Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile mbështetet nga lëndë dhe staf të cilat mbulohen dhe nga departamente të tjera. Kështu përmendim që, përvec vetë departamentit "Informatikë dhe Teknologji", përfshihen në procesin mësimor dhe Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit, Departamenti "Arte te Aplikuara" dhe Departamenti "Menaxhim dhe Marketing". Nga kjo ndërthurje kuptojmë një marrëdhënie të mirë ndërinstitucionale në funksion të plotësimit të programit master. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda | Sipas shpjegimeve të dhëna gjatë vizitës, GVJ konkludon që përvec institucioneve publike e private, IAL ka vendosur marrëdhënie të mira dhe me institucione homologe në shtete të ndryshme, si pasojë e pjesëmarrjes në projekte si partner. |

| | |
|---|---|
| dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programeve të ciklit të dytë "Master profesional", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni i arsimi të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron. | GVJ evidentoi se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione, organizata profesionale dhe biznese të ndryshme. Në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion janë dorëzuar 9 marrëveshje bashkëpunimi mes IAL dhe kompani e institucione të rëndësishme në vend si p.sh. Infosoft, Dhoma e Tregëtisë e Industrisë, etj. Në bazë të Raportit të Përfitimit nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit, vihet re dhe një fokus të rëndësishëm në aktivitetet dhe partneritetet në fushën e IT.<br><br>Qëllimi dhe objektivat e këtyre marrëveshjeve kishin në fokus realizimin e objektivave të programeve të studimeve për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore apo organizimin e trajnimeve profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit. Fokus i tyre janë dhe internshipet e studentëve, e në fakt një pjesë e studentëve i kanë ndjekur.<br><br>Sipas RVB, kompanitë që janë anëtare të Bordeve të Punës pranë Departamenteve në UET, janë shprehur të hapura në bashkëpunim për internshipet, bordet e punës, leksionet e hapura dhe vizitat në kompani. Në këtë dokument shprehet se universiteti do të vijojë orientimin në bazë të kërkesave të tregut dhe në përputhje me strategjitë për zhvillimin kombëtar, duke mos e përjashtuar mundësinë e përditësimit të kurrikulave. GVJ e vlerëson si pozitive këtë praktikë.<br><br>Në bazë të RVB, por edhe nga saktësimet e konstatuara gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se institucioni bashkëpunon me një sërë aktorësh dhe institucionesh. Projekti 250+ ka qenë një ndihmesë e rëndësishme në këtë aspekt.<br>**[Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkepunimit]**<br>**[Marreveshje Bashkepunimi mes UET dhe INSTAT]**<br>**[Marreveshje Bashkepunimi mes UET dhe ITD]**<br>**[Memorandum Bashkepunimi mes UET dhe AËARD GROUP]**<br>**[Memorandum Bashkepunimi mes UET dhe E.H.Ë]**<br>**[Marreveshja e Bashkepunimit mes UET dhe Infosoft]**<br>**[Marreveshje Bashkepunimi mes EEI & Balfin]**<br>**[Marreveshje Bashkepunimi mes UET dhe AMF]**<br>**[Memorandum Bashkepunimi mes UET dhe ËE ËEB]**<br>**[Memorandum Bashkepunimi mes Dhomes se Tregetise dhe Industrise dhe UET]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi organizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e IT dhe Inovacionit, apo konferencat, projektet etj. Ndërkohë që mungojne trajnimet e kërkuara në këtë kriter, qe i referohen atyre me natyrë profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar e kjo në bashkërendim me punëdhënësit |
| **Kriteri 6.** Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të | Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion GVJ mendon se njësia përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në "Informatië e Aplikuar" me 5 profile, realizon raporte të përfitimeve. Ndërkohë sipas RVB, në dokumentin e referuar (Ref: Analiza Vjetore |

| | |
|---|---|
| realizimit të programeve të studimeve. | e departamentit, Nr. 38), GVJ cilëson që kjo analizë duhet të jetë më e thellë si dhe me natyrë më analitike, pasi duhet të pasqyrojë konkluzionet, realizimet, pritshmëritë e një viti akademik.<br><br>**Raporti vjetor, Viti Akademik 2017 – 2018; DSSH 2019; Projekti 250+; Ndërkombëtarizimi; Raport i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimi** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

| **Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Sipas dokumentacionit të referuar (**Kurrikula e Programit, Plani mësimor dhe Rregullorja e Programit të Studimit**), programi Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, është e organizuar në module të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. Për një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një semestri është 30 kredite, kurse në total programi master në fjalë ka 60 kredite. |
| **Kriteri 2** Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Në dokumentacionet e dorëzuara nga IAL me 5 profile nuk vërehet një saktësim i pozicioneve të mundshme të punës të specialistëve të IT të cilët diplomohen në programin Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile. Ndërkohë, në **Rregulloren Mësimore të Programit** të studimit janë të caktuara në Aneks, Lista e Profesioneve/Mundësive për punësim pas përfundimit të studimeve në Informatikë e Aplikuar, si:<br><br>1. Personel IT, profili Programist Java<br>2. Personel IT, profili Baze te Dhenash<br>3. Personel IT, profili Menaxhim Rrjetash<br><br>GVJ vëren se ka nje mosperputhje p.sh. mes listës së pozicioneve të punës të ofruar si më lart në Rregulloren Mësimore të Programit, dhe përmbajtjes së ndodhur në Suplementi i diplomes, pika 5.2, sipas së cilës:<br><br>*"Disa mundesi punesimi ne perfundim te studimeve mund te permendim: Ekspert dhe drejtues ne biznese te llojeve te ndryshme,* |

| | |
|---|---|
| | *perfshire ato projektuese, zbatuese, prodhuese dhe tregtare. Ekspert dhe drejtues ne sektorin publik apo privat, perfshire bizneset, sistemin bankar, instutucionet qendrore dhe ato vendore dhe OJF. Ekspert dhe drejtues ne institucione dhe projekte nderkombetare. Ekspert dhe drejtues ne tregun e komunikimeve elektronike, perfshire operatoret e telekomunikacioneve si dhe mediat elektronike; e-ekspert dhe drejtues ne sektorin social dhe ne sektorin e arsimit publik apo privat.*<br><br>Pavarësisht kësaj, GVJ beson se ky program studimi formon njohuri të vecanta në fushën e IT e mund të jetë i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për të filluar në pozicione specialist junior ose të mesëm, analist sistemesh, specialist në animacione apo konsulencë, në atë të menaxhimit të projekteve, etj.<br><br>**Studimi periodik për tregun e punës, Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit, Analizë vjetore e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar; Suplement i Diplomes** |
| **Kriteri 3** Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.<br><br>**Kriteri 4** Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" në 5 profilet e ofruara prej tij jep njohuri konceptuale dhe praktike në fushën e IT të aplikuar në proceset e ndryshme të bizneseve apo sipërmarrjeve të tjera. Gjithashtu, ky është një program i orientuar nga praktika më shumë se ana akademike ~~(e cila plotësohet më mirë në programet Master i Shkencave~~). Gjithsesi në përbërje të strukturën së tij ofrohen lëndë të cilat nxisin të kuptuarit kritik dhe parimet akademike, vecanërisht lëndët e kategorisë A. GVJ konstaton një përpjekje mjaft të mirë të IAL në përfshirjen e studentëve në tregun e punës, apo në orientimin e tyre drejt aktiviteteve apo detyrave me natyrë profesionale. Por, programi i studimit sugjerohet të krijojë kushte lehtësuese për studentët në kryerjen e hulumtimeve, si dhe ndjekjen e metodave shkencore e të aplikueshme në Informatikë.<br><br>Sipas RVB, ky program ka objektiva të qarta përsa i përket formimit të studentëve dhe kompetencave profesionale. GVJ konsideron që programi Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, duke qenë se zhvillohet në një periudhë 1-vjecare, pra e ndarë në dy semestra, ofron njohuri dhe aftësi të mira (por jo te avancuara) qoftë menaxheriale apo teknike në profilet e vecanta.<br><br>**[Programi_MP Informatike e Aplikuar], [Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar], [Rregullore mesimore_MP Informatike e Aplikuar], [Syllabuset]** |
| **Kriteri 5** Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | GVJ vlerëson programin e studimit si të hartuar në përputhje me të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. Kjo përputhje vërtetohet në bazë të dokumentave të vënë në dispozicion, si **Rregullore e UET, pika 3.8**, si dhe në **Statutin e IAL**, të hartuar në mbështetje të **Ligjit Nr. 80/2015**.<br><br>**[Programi_MP Informatike e Aplikuar], [Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar], [Rregullore mesimore_MP Informatike e Aplikuar], [Syllabuset]** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Duke iu referuar **Rregullores Mësimore të Programit të Studimit** dhe verifikuar nga RVB, GVJ vë re që lëndët në përmbajtje të kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive (A-E), me peshën e përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL".<br>Studenti merr:<br>- në Kategorinë A 6 kredite,<br>- në Kategorinë B 18 kredite,<br>- në Kategorinë C 18 kredite,<br>- në Kategorinë D 6 kredite,<br>- në Kategorinë E 12 kredite,<br>Cdo lëndë ka 6 ECTS. Kategoria C përbëhet nga lëndë të ndryshme që formojnë dhe **karakterizojnë 5 profilet**. |
| **Kriteri 7** Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane. | Sipas programit mësimor të Masterit Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, mbështetur dhe në RVB, studentët kanë të përfshirë praktikën profesionale, si dhe kanë të parashikuar ngarkesën të shprehur në kredite. Kjo lëndë ka 6 kredite; pra një detyrim prej 150 orë punë për studentin. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. Nga këto 8 orë zhvillohen në auditor (4 seanca nga 2 orë), 120 orë në një institucion/organizatë/kompani dhe 22 orë janë punë individuale e studentit (takime me pedagogun, përgatitja e raportit përfundimtar).<br>**[RVB], Shënime nga takimet në vizitë], [Dokumenti A.III Mbi parimet e ndertimit te programit te lendes** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.<br>**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton që departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, njësi bazë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, i hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 529, datë 04.09.2018, zhvillon të gjitha veprimtaritë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton që Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, i hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 529, datë 04.09.2018, ka në përbërje tre njësi bazë: |

| | |
|---|---|
| | 1) Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë;<br>2) Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;<br>3) Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionin.<br>Kjo strukturë është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.<br>**[Statuti i UET], Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit], [URDHER Nr.527,date 04.09.2018, Riorganizimin e Fakulteti i Ekonomise], URDHER Nr.529,date 04.09.2018,Hapjen e njesise kryesore Fakulteti i Inxhinierise]** |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.<br><br>**Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë përbëhet nga 10 anëtarë të personelit akademik të brendshëm, nga të cilët:<br>- 2 anëtarë me titull Profesor,<br>- 2 Doktorë<br>- 6 Asistent Lektorë.<br>Sipas VKM nr. 418, pika XI, shprehet që "*çdo njësi kryesore duhet të ketë, të paktën, tre njësi bazë, që grupojnë disiplina mësimore të përafërta ose të ndërthurura dhe që përfshijnë fusha kërkimi respective*". Në pikën XII: "*Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik*".<br>Gjithashtu, në të njëjtën VKM janë përcaktuar raportet e personelit akademik me kohë të plotë/student, ku personeli akademik duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore.<br>GVJ konstaton që IAL përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik si dhe ruhen raportet midis personelit me kohë të plotë dhe atij të ftuar. GVJ konstaton qe stafi i punësuar me kohë të plotë që jep mësim në tre prej profileve, ato me natyrë teknike, është i pakët në numër. |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe të shprehur ne RVB, konstatohet nga GVJ që për zhvillimin e praktikave profesionale nuk është i angazhuar personel akademik ndihmës, por është ngarkuar një pedagog i brendshëm i departamentit, koordinatori i tij. **[Tabele Permbledhese te Praktikes Profesionale MP]** |
| **Kriteri 6.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Për programin Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", pranë Universitetit Europian të Tiranës, si koordinator i programit të studimit, është caktuar një lektor me titull Prof. Dr. me vendim Nr. 96, datë 03.12.2018, të Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, "Për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit". Detyrat kryesore të koordinatorit përcaktohen në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit, si edhe në aktet rregullatore të UET. Kjo pohohet dhe në RVB. |
| **Kriteri 7.** Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që | Sipas Aneks-vendimit Nr. 96 të IAL "**Për përcaktimin e detyrave të koordinatorit të programit të studimit**", shprehen detyrat dhe koordinatorit, ndër të tjera dhe ai i hartimit të raportit periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| lidhet me programin e studimit. | rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.<br><br>Kriteri 7 cilëson dhe dokumentimin e cdo informacioni që lidhet me programin e studimit nga ana e koordinatorit, gjë që nuk gjendet në listën e detyrave të koordinatorit në dokumentin e dorëzuar nga IAL. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.<br><br>**Kriteri 2.** Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.<br><br>**Kriteri 3.** Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | GVJ konstaton se njësitë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, disponojnë të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tij. Këto gjenden në **Statutin e UET**, tek **Rregullorja Mësimore e Programit Master Profesional**, apo aktet e vendimet e tjera. Një pjesë e konsiderueshme e këtij informacioni gjendet dhe në **faqen zyrtare online të IAL**.<br><br>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Këto të dhëna detajohen edhe në kurrikulën dhe rregulloren e programit të studimit, sipas së cilës, ky program zhvillon gjithsej 9 lëndë në dy semestra, të ndara në kategoritë përkatëse sipas ligjit.<br><br>Këto lëndë janë të ndara si më poshtë:<br><br>Kategoria A: 1 lëndë (6 ECTS)<br><br>Kategoria B: 3 lëndë (18 ECTS)<br><br>Kategoria C: 3 lëndë (18 ECTS) (kjo kategori ndan 5 profilet)<br><br>Kategoria D: 1 lëndë (6 ECTS)<br><br>Kategoria E: 1 lëndë (12 ECTS)<br><br>**Statuti i UET; Rregullorja Mësimore e Programit Master Profesional; Faqja zyrtare online të IAL.** |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Në dokumentin "**Plani mësimor – MP Informatikë e Aplikuar**", me 5 profile paraqitet ngarkesa mësimore, orët në auditor të ndara në: Leksione, Seminare; si dhe detyrimet e studentit jashtë auditorit në formën e Projekteve/Detyrave. Rregullat për frekuentimin si dhe për mënyrën e vlerësimit të dijeve janë të pasqyruara dhe në programet e vecanta lëndore, si dhe në Rregulloren Mesimore të programit. Në bazë të dokumentacionit, IAL përcakton një nivel frekuentimi të mësimit prej 80% të kohës për programet e ciklit të dytë.<br><br>**[Syllabuset e lëndëve], [Rregullore mesimore_MP Informatike e** |

| | |
|---|---|
| | Aplikuar], Plani mësimor – MP Informatikë e Aplikuar. |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Në lidhje me informacionit e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit, GVJ konstaton se ato janë të paraqitura dhe të detajuara në Rregulloren Mësimore të Programit. Konkretisht, për kriteret e pranimit kërkesat janë të saktësuara në Kreun 2, për transferimet dhe ekuivalentimet në Kreun 9. Për të rregulluar më tej procesin e transferimeve IAL ka vënë në dispozicion dokumentin "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve", sipas të cilit UET pranon dhe lejon transferimin e studentëve drejt dhe nga ky institucion.<br><br>GVJ konstaton se në kriteret e pranimit nuk ka rregulla specifike, pra kushte paraprake për regjistrimin e studentëve. Kjo rregullore nënkupton që këtë program mund ta ndjekin studentë nga cfarëdo programi bachelor.<br><br>**Rregullore Mësimore e Programit**<br><br>**Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve** |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Në bazë të RVB dhe dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi që informacioni i detajuar për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet në programin lëndor të detajuar, i cili miratohet përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i grup lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Silabuset hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse (Shtojca Nr. 2 e VKM Nr. 41, datë 24.01.2008 "Për elementët e programeve të studimit" dhe Dokumentit **A.III. të Broshurës së Dokumenteve UET**.Gjithashtu gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh dhe më tej me formatet e miratuara, të cilat janë të plota dhe orfrojnë informacion të detajuar mbi: të dhënat të përgjithshme të lëndës, qëllimi dhe objektivat, kalendari i temave, forma e vlerësimit, literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar etj. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita në institucion gjatë takimeve me anëtarë drejtues të njësive bazë dhe kryesore se programet mësimore dhe përmbajtjet e tyre lëndore janë në përmirësim të vazhdueshëm. Kjo konsiderohet si një aspekt pozitiv dhe shpesh i domosdoshëm për profile teknike si ai i Masterit Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile. GVJ gjithashtu vuri re se një nga arsyet e bashkëpunimit të Bordit të Punës, të përbërë nga alumni të UET, me strukturat e IAL ishte pikërisht mundësia e përmirësimit të programeve sipas asaj cfarë tregjet e punës kërkojnë për këto drejtime.<br><br>Sipas Rregullores së programit të studimit, pika 10, parashikohet se Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Programet lëndore përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët. Sipas shpjegimeve gjatë vizitës, ato kontrollohen dhe nga Zyra e Cilësisë së IAL. **[Detyrat e koordinatorit te programit te studimit]**, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | [Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve] [Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyres se Kurrikulave], A-III-8-2 Indikatoret e vleresimit te programit te lendes], [Plani Veprimit_KSBC_2018-2019] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | GVJ evidentoi që ngarkesa e programit të studimit në masterin profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, 60 kredite dhe kohëzgjatje normale 1 vit akademik është në përputhje me nenin 75, pika 6, të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i cili përcakton se programet profesionale organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Nga Plani mësimor del sel se:<br>- **Për leksionet** 1 kredit është ndarë në 11.2 orë në auditor/13.8 orë punë e pavarur<br>- **Për seminaret** 1 kredit është ndarë në 7 orë në auditor/18 orë punë e pavarur<br>- **Për projektet** 1 kredit është ndarë në 12 orë në auditor/13 orë punë e pavarur<br>- **Për punimin e diplomës** 1 kredit është ndarë në 2 orë në auditor/23 orë punë e pavarur.<br>Në lidhje me raportet mes orëve në auditor dhe punës së pavarur, GVJ konstaton që ato ruhen në mënyrë të kënaqshme, me përjashtim të projekteve, kur orët e pavarura duhet të jene më tepër se ato në auditor.<br>[Programi_MP Informatike e Aplikuar], [Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar], [Syllabuset e lëndëve] |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. | GVJ, pas një shqyrtimi të detajuar të përmbajtjeve të veprimtarive dhe të emërtimeve të tyre, të shpërndarjes së lëndëve dhe ndarjes së tyre në profilet përkatëse të programit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile është i mendimit se disa lëndë duhet të rishikojnë përmbajtjen e tyre në syllabus-et përkatës. Kështu p.sh. GVJ sugjeron që:<br>1. në emërtimet e lëndëve të hiqen termat "E avancuar"; lënda "Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit" qe vjen nga Management Information Systems, duhet të emërtohet si "Sistemet e Informacionit të Menaxhimit".<br>2. Në brendësi të programeve lëndore të detajohen pjesët praktike në mënyrë më konkrete. |

| | |
|---|---|
| | 3. Lëndët të mos jenë bashkim i dy disiplinave apo moduleve, pasi rrezikohet që dija në to të jepet në mënyrë sipërfaqësore (p.sh. Kriptografi dhe Ethical Hacking, apo Menaxhim dhe Vlerësim, etj.)<br>4. Lëndët në përgjithësi kanë nevojë për një rishikim të përmbajtjes së tyre në mënyrë që të eliminohen përsëritjet, të jenë të linjëzuara në të gjithë planin e programit mësimor, si dhe të zgjidhen në mënyrë të tillë, që të jenë saktësisht thelbi i secilit prej profileve. P.sh. lënda Menaxhimi i riskut në IT, shihet më shumë si lëndë e mirëfilltë Siguri Informacioni ose Sistemesh Kompjuterike; lënda "Aplikimi i Sistemeve të Informacionit" është në përmbajtjen e saj "Inxhinjerim softesh" e për pasojë GVJ sugjeron riemërtimin e saj; lënda Zhvillim i avancuar i softuerëve është në përmbajtjen e saj vetëm "Programim në platformat mobile".<br>**[Programi_MP Informatike e Aplikuar], [Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar], [Syllabuset e lëndëve]** |
| **Kriteri 3.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.<br>**Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.<br>**Kriteri 8.** Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | GV konstaton që shpërndarja e ngarkesës mësimore në dy semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.<br>Cdo lëndë në programin e Masterit Profesional me profile ka 6 kredite dhe ngarkesa nëpër lëndë janë të përafërta. Përjashtim ka Diploma, e cila ka 12 ECTS, pasi është më shumë punë e pavarur jashtë auditorit.<br>GVJ konstaton se programi i programit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile në përgjithësi synon nxitjen e studentëve për përvetësimin e dijeve bashkëkohore, si dhe përfitimin e aftësive praktike, e bërë kjo në përputhje me synimet e një programi master profesional. Konkretisht në auditore, në bazë dhe të vizitës së GVJ në IAL në takimin me studentë, u vu re një nivel mesatar kompetencash. GVJ sugjeron rritjen dhe përmirësimin e anës praktike të secilës lëndë të profilit, si dhe një përqasje tjetër në kriteret e pranimit të studentëve në programin master profesional të kësaj natyre, sic është shprehur dhe në kriteret e mësipërme. Kjo do të rrisë cilësinë e programit në tërësi dhe ngritjen e kompetencave për profesionistë IT që zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë.<br>**[Programi_MP Informatike e Aplikuar], [Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar], [Syllabuset e lëndëve]** |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.<br>**Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, | GVJ vëren që ky program është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit tonë, është i përshtatshëm për vendet e punës të ofruara në fushën e IT (në nivel junior ose si specialist sipas secilit profil), por nevojitet të saktësohet më shumë brenda programeve lëndore në lëndë të vecanta aftësitë praktike dhe qasjet kërkimore-shkencore, nga të cilat do të përfitojë studenti.<br>Raporti Teori Praktikë, i përllogaritur si raporti: (orë totale leksioni + orë totale seminari) / (orë Lab + Ushtrime + praktike + tjetër), në programin Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile është përllogaritur në bazë të dokumentit "Plani Mësimor MP Informatikë e Aplikuar", si dhe lëndëve të përcaktuara në "Programi |

| | |
|---|---|
| mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | MP Informatikë e Aplikuar". Sipas këtyre llogaritjeve, secili profil ka në përbërje të strukturës mësimore 7 lëndë me nga 6 ECTS, të ndara si më poshtë:<br>**6 ECTS x 7 lëndë = 42 ECTS**<br>2.5 ECTS leksione x 7 lëndë = 17.5 ECTS<br>2 ECTS seminare x 7 lëndë = 14 ECTS<br>1.5 ECTS project/detyra x 7 lëndë = 10.5 ECTS<br>Pra, TEORI janë 31.5 ECTS, kurse PRAKTIKE janë 10.5 ECTS vetëm për lëndët e profileve. GVJ konstaton një raport të lartë të teorisë ndaj praktikës, vetëm për lëndët e kategorive A, B, C. Por, këtyre vlerave nëse i shtojmë 18 ECTS të Praktikës Profesionale dhe Punimit të Diplomës (lëndët e kategorive D dhe E), atëhere raporti shkon në vlerat 31.5/28.5. Kjo përllogaritje është e njëjtë për të 5 profilet.<br>Gjithashtu, GVJ pohon që lëndët mbështeten nga literaturë e huaj të rëndësishme të fushës, që janë ofruar dhe në universitete të tjera jashtë vendit, por konstatohet që këto burime nuk janë rifreskuar me materiale të reja.<br>GVJ konstaton se ka një raport të përshtatshëm në ndarjen e veprimtarive formuese. Mund të shtohet dhe një modul tjetër në lëndët e Kategorisë A, për të plotësuar më mirë këtë kategori (që aktualisht ka vetëm një lëndë, për shembull Metoda Kërkimi). Gjithashtu, natyra praktike e Masterit Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile duhet të saktësohet më qartë dhe në syllabus-et e lëndëve, në të cilat duhet të saktësohen orët në laborator dhe punët praktike në terma të krediteve.<br>**[Programi_MP Informatike e Aplikuar], [Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar], [Syllabuset e lëndëve]; [Programi_MP Informatike e Aplikuar]** |
| **Kriteri 6.** Programet e lëndëve/ moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Sipas RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion (Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional), Departamenti i Informatikës dhe Teknologjise përditëson në mënyrë periodike literaturën bazë dhe të detyrueshme të programit të studimit. Këto ndryshime bëhen në fillim të secilit semestër, ku theksimi është në përfshirjen e botuesve të rëndësishëm si Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraë-Hill, si edhe botime me njohuri bazë ose të avancuara, të të njëjtave kritere, të shtëpive botuese Sage, Routledge, Pearson dhe Elsevier. Pavarësisht titujve të vendosur në syllabus-et e lëndëve përkatëse, të cilët janë tekste mjaft të mira në vetvete, GVJ konstaton që:<br>1. Literatura e cituar nën seksionet: a. Literatura bazë e detyrueshme, dhe b. Literatura e rekomanduar, nuk ndjek në mënyrë konsistente të njëjtin standard referimi (p.sh. APA style, apo të tjerë).<br>2. Në këto bibliografi, në pjesën më të madhe të tyre, mungon vendosja e vitit të botimit (i detyrueshëm në cdo standard). Për |

| | |
|---|---|
| | pasojë, nuk mund të themi kohën e botimit të tyre.<br>3. Një pjesë e lëndëve i kanë vitet të shprehura në literaturat e lëndëve, por këto janë mbi 5 vite të vjetra, pra më herët se 2015. Kjo shihet dhe në lëndë që kanë pësuar një ndryshim mjaft të shpejtë vitet e fundit, si p.sh. Menaxhimi i Big Data (Bibliografi viti 2013). **[Programi_MP Informatike e Aplikuar], [Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar], [Syllabuset e lëndëve]** |
| **Kriteri 9.** Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Në RVB, raporti shpreh se programi synon të transmetojë aftësi dhe shprehi te studentët për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, mbështetur edhe në lidhjet e krijuara me partnerët konkretë të tregut të punës të përfaqësuar në Bordin e Tregut të Punës të Departamentit, si dhe përmes programit 500+. Në bazë të legjislacionit shqiptar për Arsimin e Lartë, studentët që mbarojnë një diplomë Master Profesional, nuk mund të vijojnë më tej studimet e Nivelit të Tretë. Gjithsesi, këta specialistë mund të kualifikohen (p.sh. me anë të Certifikatave) në mënyrë individuale e në varësi të profileve të tyre të punës. **[Programi_MP Informatike e Aplikuar], [Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar], [Syllabuset e lëndëve]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Standardi II.5**<br>**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.<br><br>**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile është me grada dhe tituj, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.<br><br>Sipas VKM nr. 418, janë përcaktuar raportet e personelit akademik me kohë të plotë/student, ku personeli akademik duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore.<br><br>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit përbëhet nga 13 anëtarë të personelit akademik, 8 të angazhuar me kohë të plotë dhe 5 me kohë të pjesshme.<br><br>Raporti numerik del 61% PAE /39% PAK<br><br>Duke llogaritur ngarkesën mësimore në kredite të stafit PAE dhe PAK, në secilin profil rezultojnë këto raporte:<br><br><u>Profili 1</u>: 70% PAE me 30% PAK<br><br><u>Profili 2</u>: 50% PAE me 50% PAK<br><br><u>Profili 3</u>: 60% PAE me 40% PAK<br><br><u>Profili 4</u>: 50% PAE me 50% PAK |

| | |
|---|---|
| | Profili 5: 80% PAE me 20% PAK<br><br>Pra vetëm dy profile përmbushin kriteret ligjore për ngarkesën.<br><br>Nga pikëpamja e kualifikimit akademik personeli me kohë të plotë përbëhet nga:<br><br>- 3 Prof. Dr.,<br>- 2 Prof. Asoc. Dr., dhe<br>- 3 Dr.<br><br>Stafi i ftuar përbëhet nga:<br><br>- 2 Dr. dhe<br>- 3 MSc.<br><br>Në bazë të të dhënave tabelare të vëna në dispozicion nga IAL (Stafi akademik për programin e studimit "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile, viti akademik 2019-2020) anëtarët e stafit të ftuar vijnë nga institucione publike dhe private dhe kanë profil të përshtatshëm për tu anagazhuar në programin e studimit.<br><br>**[Stafi akademik i programit MP Informatike e Aplikuar], [Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik], [MP Inf. Aplikuar]** |
| **Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Sipas RVB, përzgjedhja e pedagogëve që do të japin një lëndë të caktuar realizohet bazuar në ekspertiza akademike dhe kërkimore të pedagogut, përvojës në fushën e mësimdhënies. Si rregull, anëtari më i kualifikuar i personelit akademik mbulon lëndën/lëndët që kanë lidhje më të drejtpërdrejtë me specifikat e programit përkatës.<br><br>GVJ e konstaton që, sipas Curriculum Vitae, ata të cilit IAL i ka vënë në dispozicion Curriculum Vitae, ky kriter plotësohet, por ka ende mundësi për tu përmirësuar. **[CV e stafit]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Në bazë të dokumentacionit të vëne në dispozicion, si dhe nga shpjegimet e marra gjatë vizitës së IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që institucioni ka një sërë marrëveshjesh me biznese, kompani, apo instittucione publike, të cilat synojnë të vendosin një bashkëpunim të mirë për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve.<br><br>Praktika profesionale është gjithashtu një proces i mirëmenaxhuar nga institucioni, ku një pjesë të semestrit të dytë studentët ndjekin zhvillimin e proceseve dhe fitojnë eksperiencë në lidhje me mjedisin e punës. Në fund të kësaj periudhe, secili prej tyre mbron eksperiencën e fituar përpara një komisioni të ngritur nga departamenti.<br><br>Pas realizimit me sukses të praktikës profesionale, si dhe përmbylljes së të gjithë detyrimeve ndaj IAL, studentët kalojnë në procesin e punimit të diplomës. Atyre iu ofrohen nga IAL dhe seanca informuese në lidhje me metodologjitë e ndjekura në implementimin dhe shkrimin e diplomës (**dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës/disertacionit**, etj). |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton | Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që në nivel fakulteti institucioni ka zyrën e IT, stafi i të cilit merret me mirëmbajtjen e |

| | |
|---|---|
| angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | instrastrukturës në dispozicion të programeve, dhe sigurojnë mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikës mësimore. Kjo zyrë ka katër punonjës, të cilët punojnë si në mbështetje të programit mësimor, ashtu edhe me çështje të infrastrukturës që IAL zotëron dhe menaxhon për orët praktike të lëndëve.<br><br>**[Vizita në Institucion]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, në **Statutin e UET**, neni 30, pika 30.4 parashikon se çdo program studimi, konsultohet në mënyrë të herëpashershme me Bordet e Tregut të Punës, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive, dhe ai mund të ndryshojë për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Këtë, GVJ e konfirmon dhe nga shpjegimet e dhëna gjatë vizitës në institucion, por që kriteri (sic është i shprehur në këtë raport) të konsiderohet i plotësuar, duhet që këto konsulta e propozime, që më pas kthehen në vendime në kuadër të përmirësimit të programeve të studimit, të jenë dhe të dokumentuara. |
| **Kriteri 2.** Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit. | Në IAL, prej disa vitesh, Bordi i Tregut të Punës është krijuar me anëtarë nga radhët e UET Alumni, të cilët kanë zhvilluar një karrierë të spikatur profesionale pranë institucioneve ku janë punësuar. Një herë në muaj, Departamenti zhvillon mbledhje të hapur për studentët e programeve të tij, me qëllim që ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit e më gjerë. GVJ nuk ka në dispozicion një dokument që e vërteton reflektimin e tyre në programin mësimor (procesverbal, memo, shkresë tjetër).<br><br>GVJ konstaton se IAL angazhohet seriozisht në organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve ALUMNI që funksionojnë pranë UET, duke i përfshirë gjithnjë e më shumë ALUMNI-t në strukturat konsultuese e drejtuese të universitetit, si dhe duke i angazhuar në aktivitete/projekte zhvilluese të UET. Një politikë e tillë është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga UET dhe vazhdon të jetë në qendër të **Planit Strategjik 2015-2020**, pjesa **"Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore", pika 3**.<br><br>**Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Planit Strategjik 2015-2020** |
| **Kriteri 4.** Në bashkëpunim me | Sipas prioriteteve të caktuara për vendin tonë, duke qenë se profilet |

| | |
|---|---|
| institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi. | me drejtim IT janë gjithmonë të kërkuara e për të cilat ka mjaft nevojë tregu, edhe programi i Masterit Profesional "Informatike e Aplikuar" me 5 profile është pikërisht rezultat i nevojës për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës për kualifikimin e nëpunësve të angazhuar në procese pune të lidhura me informatikën. Një inkurajim për zhvillimin e këtij programi, IAL e merr dhe nga UET Alumni nëpërmjet Bordit të Tregut të Punës.<br><br>**[vizita në institucion]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | GVJ konstaton që institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në përgjithësi. Kështu, në **Rregulloren e UET** përshkruhen në mënyrë të detjuar mënyrat e hartimit të syllabus-eve, metodat e mësimdhënies, sistemi i kontrollit të dijeve, etj. Për të verifikuar implementimin e tyre, GVJ kontrolloi dhe programet e lëndëve, në të cilat saktësohen edhe me tepër se cilat metodolgji do ndjekë lektori në leksion apo seminar.<br><br>**Rregullore e UET** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Në bazë të RVB, dokumentave të vënë në dispozicion, si dhe shpjegimeve të marra gjatë vizitës në IAL, konstatohet se institucioni zhvillon mekanizma monitorimi dhe vlerësimi të cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik. Këto mekanizma janë: (a) të drejtpërdrejta nëpërmjet asistimit në sallë nga strukturat e larta të njësisë bazë/kryesore; (b) vlerësimi nga studentët në fund të semestrit me anë të pyetësorëve online; (c) nëpërmjet një strukture studentore të quajtur focus-group; (d) vetëvlerësimi; (e) Komisioni i Vlerësimit të Përformancës që ngrihet nga Rektori; (f) Leksione të hapura.<br><br>GVJ konstatoi që në IAL funksionon një sistem kompleks për menaxhimin e proceseve mësimore (mësimit, vlerësimit të lëndës, frekuentimit, etj) që përfshin dhe menaxhimin e vlerësimit të studentëve për secilën lëndë në fund të semestrit. Këto vlerësime janë jo vetëm për aspekte të mësimdhënies, por edhe në drejtimin e etikës |

| | |
|---|---|
| | së komunikimit, mbështetjes së studentëve si dhe mbarëvajtjes së përgjithshme të orës së mësimit dhe kërkesave të studetëve që lidhen me to. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh konkretisht me disa shembuj të vlerësimeve të pedagogëve.<br><br>Studentët mund të shprehin mendimet apo ankesat e tyre edhe në mbledhjet e departamentit, ose me kërkesë drejtuar përgjegjësit të departamentit, si dhe në struktura të tjera, si ajo e Zyrës së Kujdesit të Studentit.<br><br>**[Detyrat e koordinatorit te programit te studimit], [Vendimi emerimit te koordinatorit te programit], [Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve], [UET_Raporti Vjetor 2017-2018], [Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë], [Plani Veprimit_KSBC_2018-2019], [Strategjia per Sigurimin e Brendshem te Cilesise_2017-2022]** |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Në bazë të RVB, rezultatet e vlerësimit përpunohen nga KSBC, dhe nga zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit. Departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme.<br><br>Gjatë vizitës u verifikua që cdo rezultat i vlerësimit nga studentët arkivohet në dosjen personale të pedagogut. U panë disa prej tyre. **[Vizita në Burimet njerezore]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Në dokumentin "**Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë" pika F. VII. 3,** theksohet që '*...qëllimet e tij janë: rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të UET, të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore në UET, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore...*". Kontrolli periodik dhe shumëplanësh, që u evidentua të zhvillohej në institucion, bën që personeli akademik të mund të mësojë praktikat e mira, si në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, ashtu edhe në aspekte të tjera të punëve të tij brenda institucionit.<br><br>**Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë | Në bazë të dokumentave të ndryshëm të vënë në dispozicion të GVJ, si dhe nga vizita gjatë institucionit, u konstatua që procesi mësimor zhvillohet me leksione, me seminare, leksion/seminare, me detyra praktike dhe me detyra kursi, praktikat profesionale, punim diplome ose provim të përgjithshëm përfundimtar. |

| | |
|---|---|
| tjetër e miratuar nga institucioni. | GVJ konstaton që format e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë sipas kategorive të ndryshme, sic kërkohen në këtë kriter.<br><br>Nga plani mësimor për cdo profil, rezultojnë:<br>- Leksione: **196** orë mësimore në auditor<br>- Seminare **98** orë mësimore në auditor<br>- Projekte: **126** orë mësimore në auditor<br>- Praktikë **120** orë mësimore në auditor<br>- Punim diplome **26** orë mësimore në auditor<br>- Gjithsej **566 orë në auditor** dhe **934 orë punë individuale**<br><br>Raporti i orëve në auditor dhe orëve të vëna në dispozicion për punë individuale tregon që programi i studimit i jep avantazh orëve të zhvilluar si punë individuale. Diferenca prej 368 oresh, e përkthyer në kredite, nënkupton rreth 14.7 ECTS me teper punë individuale për studentët. Kjo mund të shihet si positive nga GVJ, në kuadrin e një Masteri Profesional.<br><br>Sipas syllabus-eve të lëndëve u vu rë që përvec provimit përfundimtar, kontrolli i dijeve bëhet i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Institucioni ka zhvilluar dhe leksione të hapura me ekspertë të IT, apo përfaqësues të kompanive që operojnë në fushën e IT.<br><br>**[Programi_MP Informatike e Aplikuar], [Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar], [Syllabuset e lëndëve]** |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | Sipas RVB, por edhe në bazë të dokumentacionit të konsultuar, GVJ evidenton që personeli akademik ka respektuar diversitetin e studentëve. Sipas vizitës në IAL, në takimin me studentët, duke qenë se shfaqin heterogjenitet në formimin e tyre Bachelor, ata mendojnë që shtimi i pjesëve praktike në lëndët e profilit do ishte edhe më në dobi të avancimit të tyre praktik dhe për pasojë rritjes së mundësisë së punësimit të tyre në një profil të fushës së IT.<br><br>**[Vizita në Institucion, takimi me studentët]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | Sipas RVB, sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion lidhet dhe me trajnimin e pedagogëve. Institucioni ka një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore.<br><br>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re anën logjistike të sallave, të bibliotekës apo të ambienteve të tjera, të cilat vërtetojnë përdorimin e pajisjeve dhe metodave bashkëkohore të të nxënit.<br><br>Institucioni ka të ngritur dhe Komisionin e Vlerësimit të Performancës së personelit akademik, i cili vlerëson të gjithë personelin e angazhuar me kohë të plotë dhe të ftuar. Raporti përfundimtar i performancës ndihmon stafin të përmirësojë aspekte të caktuara, si dhe vlen si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të |

| | |
|---|---|
| | punësimit. Gjithashtu institucioni kryen dhe trajnimin në vazhdimësi të personelit: (a) certifikata e mësimdhënies; (b) certifikata e kërkimit shkencor; (c) certifikata e drejtimit të grupit kërkimor; (d) certifikata për menaxhimin; etj, të cilat janë të detyrueshme për anëtarët e stafit të vendosur në pozicionet përkatëse.<br><br>**[Te dhena mbi trajnimet profesionale], [Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik]** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.<br><br>**Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.<br><br>**Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Pas shqyrtimit të Curriculum Vitae të dorëzuara nga IAL për anëtarët e stafit që japin mësim në programin Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, GVJ arrin në përfundimin që ky personel akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive, si pasojë e edukimit të tyre, përvetësimit të titujve dhe gradave apo edhe nga eksperienca e tyre profesionale në kompani apo projekte IT. Per lendet e profesionit sugjerohet rishikim i programeve, si dhe i literaturave. **[CV e stafit], [Te dhena mbi trajnimet profesionale], [Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik]**<br><br>Sipas strukturës organizative të UET, ngritja e zyrave të ndryshme, apo bërja pjesë e kompetencave të përgjegjësve të departamenteve, dekanëve, apo stafeve të tjera menaxhuese të institucionit, të vlerësimit të performancës së lektorëve nga studentët, bën që GVJ të konstatojë që IAL e vlerëson dhe përpiqet të përmirësojë mësimdhënien në përgjithësi. Ka pasur raste, sipas informacioneve të marra gjatë vizitës, që këto vlerësime kanë qenë përcaktuese për vazhdimësinë e punës në UET. Studentët mund të japin dhe sugjerime në lidhje me kurrikulën e programit, si dhe janë përfshirë dhe në strukturat organizative sipas legjislacionit në fuqi.<br><br>Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi që një pjesë e mirë e pedagogëve prezentë në takim përdorin metoda interaktive dhe diskutimi me studentët. Vlen për tu përmendur që lëndët që zhvillohen nga departamente të tjera përshtaten dhe për profilin e IT (p.sh. Aftësitë Menaxheriale). Nga vëzhdimi i syllabus-eve të detajuar të lëndëve, GVJ konstaton dhe lëndë të caktuara që përfshijnë diskutimin e rasteve, punën në grup, etj.<br><br>Sipas RVB, stafi akademik inkurajon autonominë dhe mendimin kritik të studentëve nëpërmjet literaturës së rekomanduar, ose artikujve shkencorë të dhënë për t'u studiuar në mënyrë të pavarur Keshtu, GVJ konkludon se në këtë mënyrë arrihet zgjerimi i konsiderueshëm i të nxënit jashtë auditorit, në mënyrë të pavarur. Për të kultivuar bashkëpunimin midis studentëve, detyrat e kursit në programet master zhvillohen përmes prezantimeve në grup të studentëve. Kjo formë vlerëson jo vetëm dijet e studentëve, por edhe aftësitë e punës në grup, si edhe bën që studentët të mësojnë nga njëri-tjetri.<br><br>**[CV e stafit], [Te dhena mbi trajnimet profesionale], [Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik], Dokumenti A.III Mbi parimet e ndertimit te programit te lendes], [Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik]** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Standardi III.3<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.<br><br>**Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave. | Gjatë vizitës në institucion, në bazë të RVB, si dhe duke shqyrtuar dokumentin "**Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit**", GVJ konkludon që procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore. UET ka në dispozicion 3 godina: A, B dhe C. Në godinën B ndodhen 4 laboratorë informatike me kapacitete (25 PC, 35 PC, 35 PC dhe 80 PC) ku zhvillon një pjesë të leksioneve edhe Masteri Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile<br><br>Në bazë të vizitës dhe RVB ambjentet e UET janë të pastra si rrjedhojë e punës që bëhet nga stafi i punësuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambjenteve te institucionit<br><br>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar ("Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit"), UET ka 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë të aksesojnë bibliotekat online. **[Infrastruktura në funksion të programeve të studimit [Inventari i teksteve], [Vizita në institucion]** |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. | Në bazë të dokumentacionit, institucioni ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Përmendim sistemin MOODLE (UET LMS), që bën të mundur që studenti në kohë reale të azhornohet me materialet e hedhura nga pedogogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Ky sistem u demonstrua dhe gjatë vizitës në IAL në mënyrë të detajuar. **[Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS], [Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS], [UET LMS - Guide per pedagogun], [UET_LMS_Guide per studentet]** |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Gjatë vizitës në institucion, GVJ mundi të shihte nga afër ambjentet e Bibliotekës së UET. U konstatua literatura në dispozicion të studentit në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore të Masterit Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile. Sipas RVB, Biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage & Ebsco si edhe Questia. **[Infrastruktura në funksion të programeve të studimit [Inventari i teksteve], [Vizita në institucion] [Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS], [Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS], [UET LMS - Guide per pedagogun], [UET_LMS_Guide per** |

| | |
|---|---|
| | **studentet], [Syllabuset e lëndëve]** |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Sipas RVB dhe dokumentit "Inventari i teksteve", konstatohet një numër i mjaftueshëm botimesh në funksion të lëndëve të ndryshme pjesë e literaturave, botime të rekomanduara, tema master dhe doktoraturë, etj. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkuara nga pedagogët dhe studentët. Biblioteka ka 12 kompjutera dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjeti ëireless.<br><br>Gjatë vizitës në IAL, si dhe nga informacioni i marrë nga dokumenti "Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit", Godina C (Biblioteka) është gjithsej me një sipërfaqe 300 m2, e pajisur me ambjente komode, të ngrohta, dhe me orare të përshtatshme për studimin e pavarur të studentëve. **[Infrastruktura në funksion të programeve të studimit [Inventari i teksteve], [Vizita në institucion]** |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Sikurse u përmend në kriteret e mësipërme, në mjediset e IAL është lehtësuar aksesi në libraritë online si për personelin akademik, ashtu edhe për studentët. Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UET. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton që institucioni ka infrastrukturën e nevojshme për realizimin e laboratorëve apo objektivave të tjera mësimore. Konkretisht, në dispozicion të studentëve janë 4 Laboratorë Informatike, përkatësisht:<br>- Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 $m^2$;<br>- Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 $m^2$;<br>- Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 $m^2$;<br>- Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit) – 160$m^2$.<br><br>Studenti mund të punojë në Bibliotekë ose në sallën e internetit për detyrat e kursit apo punimin e diplomës që duhet të shkruajë. **[Infrastruktura në funksion të programeve të studimit], [Vizita në institucion]** |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.<br><br>**Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | Gjatë vizitës në institucion, GVJ mundi të shohë të demonstruar platformën online UET LMS, e vënë në dispozicion të lektorëve dhe studentëve. Sipas Urdherit administrativ për LMS, nr.09, date 02/11/2017 Mbi zbatimin e plotë në procesin mësimor administrativ të platformës UET LMS, personeli akademik, në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimëdhënies në UET dhe menaxhimin efektiv të tij, urdhërohet vendosja në eficencë të plotë e platformës UET LMS me të gjitha funksionet e saj. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime, ngarkon syllabusin, prezantimet, leksionet, hedh pikët e çdo vlerësimi për studentët e tij, etj. Detajet e tjera të platformës janë të sqaruara në dokumentacionin e dorëzuar.<br><br>Platforma Moodle mbi të cilën ngrihet dhe është personalizuar UET LMS lejon që të gjithë përdoruesit e saj (lektorë, studentë apo |

| | |
|---|---|
| | administratorë, etj), të mund të komunikojnë mes tyre, të bëjnë upload të dokumenteve, të disutojnë në forume, si dhe të mund të shkarkojnë leksionet dhe cdo material tjetër të vendosur në dispozicion nga lektori i lëndës. **[Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS], [Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS], [UET LMS - Guide per pedagogun], [UET_LMS_Guide per studentet], [Syllabuset e lëndëve]** |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Në dokumentin e vënë në dispozicion (B. II. Mbi punimin e diplomes/disertacionit) qartësohet mënyra e zgjedhjes dhe miratimit të temës për programet me karakter profesional, sic është dhe ai i “Informatikë e Aplikuar” me 5 profile. Sipas pikës B. II. 2. 2., në fillim të muajit tetor, çdo Departament organizon mbledhjen e Bordit të Tregut të Punës për të konsultuar tematikat e ndryshme, që mund të shërbejnë si objekt studimi në nivel diplome, si edhe për të identifikuar udhëheqësit potencialë të këtyre studimeve.Studentët, në bazë të mesatares, mund të realizojnë si punim diplome: (a) projekt profesional me karakter aplikativ/praktik; (b) studim i një rasti ose studim krahasues që hyn shumë thellë në problematikën e një rasti të veçantë studimi (“case study”), (c) shkrim i një projekti profesional, ose (d) ndërtim i një aplikacioni për programe në fushat si informatika.<br><br>I gjithë procesi nga aplikimi deri tek dorëzimi i punimit dhe mbrojtja e temës, është i rregulluar në dokumentacionin e IAL. Pedagogët udhëheqës realizojnë seancat metodologjike për të asistuar dhe mbështetur studentët gjatë fazës së shkrimit të temës, sipas një kalendari takimesh, të shpallur. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Në IAL Universiteti European i Tiranës, vepron Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ndër detyrat e kësaj structure është të vlerësojë periodikisht veprimtaritë e mësimdhënies si dhe ato të kërkimit shkencor. Gjithashtu, Zyra e Standarteve dhe Cilësisë kujdeset për kuadrin rregullator të institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br><br>Përvec këtyre strukturave të dedikuara janë dhe strukturat drejtuese dhe autoritetet të institucionit, të cilat janë gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë.<br><br>**Statuti i UET** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është | Për Masterin Profesional “Informatikë e Aplikuar” me 5 profile, |

| | |
|---|---|
| përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | është përgjegjës departamenti i "Teknologjisë dhe Informatikës", Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës.<br><br>Ai kujdeset për cilësinë e mësimdhënies, përzgjedh personelin akademik, si dhe bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me rregullatorët e institucionit si dhe bazuar në ligjet e arsimit të lartë.<br><br>Programi mësimor ka dhe një staf të dedikuar, që është koordinatori i programit, përgjegjës për ecurinë e zhvillimin e kurrikulës, për të garantuar respektimin e parimeve dhe kritereve të përcaktuara në aktet rregullatore të miratuara, e për të siguruar përditësimin e tyre me të rejat e shkencave përkatëse dhe kërkesat e tregut të punës. Për programin në fjalë koordinatore është zgjedhur një lektor me titull Prof. Dr., që plotëson kriteret e vendosura në ligj. Koordinatori është anëtar efektiv departamentit, detyrat e së cilit janë të caktuara në Aneksin "Për përcaktimin e detyrave të koordinatorit të programit të studimit".<br><br>Nga vizita në institucion, GVJ u informua që departamenti zhvillon mbledhje periodike cdo ditë të martë, procedurë kjo që ndihmon edhe më tepër në rritjen e vetëdijës për cilësinë e programit.<br><br>**Për organizimin dhe funksionimin e departamentit; Vizita në IAL** |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | GVJ konstatoi s inga RVB, ashtu dhe nga vizita në IAL që departamentin "Teknologji dhe Informatikë" mbështet zhvillimin e metodave të reja innovative të mësimdhënies. Sistemi UET LMS është një prej tyre.<br><br>**Vizita në IAL; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.<br><br>**Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Në dokumentet e vëna në dispozicion, si dhe gjatë takimit me stafin e departamentit "Teknologji dhe Informatikë", GVJ konstatoi që ky staf mbështetet dhe inkurajohet të kualifohet në mënyrë të vazhdueshme. Kështu, në Statutin e UET (pika 36.2), në Strategjinë e Kërkimit Shkencor në UET 2017-2020, vërehet që institucionit e ka në vëmendje kualifikimin e përhershëm të stafit akademik dhe studentëve.<br><br>Një aspekt tjetër shumë domethënës që vërteton këtë pjesë, sipas GVJ, është dhe pjesëmarrja mjaft aktive e anëtarëve të institucionit në projekte të ndryshme ndërkombëtare, në të cilët janë angazhuar edhe si kërkues shkencorë, por edhe janë trajnuar, kualifikuar, udhëtuar në institucione të ngjashme ndërkombëtare.<br><br>Sipas RVB, personeli akademik i UET mund të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar trajnimet e herëpashershme nga lektorë të ftuar, apo anëtarë të personelit të UET (zyra e IT, apo njësi të tjera). Por, në dokumentin Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin, GVJ gjen 5 aktivitete në total të zhvilluara prej vitit 2014-2017.<br><br>**Statuti i UET; Strategjia e Kërkimit Shkencor në UET 2017-** |

| | |
|---|---|
| | **2020; Vizita në IAL** |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Sipas RVB, përdorimi i metodave të reja në mësimdhënie mbetet përgjegjësi individuale e personelit akademik. Institucioni bën përpjekje për të promovuar përdorimin e këtyre metodave, por përsëri vihet re se përvetësimi dhe shfrytëzimi i tyre në mësimdhënie përqafohet më kollaj nga brezi i pedagogëve të rinj, ndërkohë që përdoren më pak nga brezi i atyre me më shumë përvojë (vite eksperiencë pune).<br><br>Kjo u konfirmua dhe nga takimi në institucion me strukturat drejtuese të zyrës së IT.<br><br>**Vizita në IAL** |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Në IAL, u konstatua nga GVJ që personeli inkurajohet të testojë metoda të reja bashkëkohore. Shembull për këtë është sistemi UET LMS. Si protokoll pune, nëse gjatë punës së tyre lektorët vënë re se një eksperiencë e re është efektive, ata raportojnë për rezultatet në mbledhjen e departamentit, me synim që kjo eksperiencë pozitive të përhapet dhe shfrytëzohet edhe nga kolegët e tjerë. |
| **Kriteri 8.** Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. | Për të plotësuar ngarkesën mësimore me lektorë që janë edhe profesionistë të IT, në institucion bëhet i mundur edhe angazhimi i lektorëve të ftuar. Sipas RVB, ky shihet si element shumë i rëndësishëm për pasurimin e procesit të mësimdhënies dhe lidhjen me tregun e punës, e sidomos në rastin e programit Master Profesional në "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile. Këto burime njerëzore shërbejnë për të katalizuar dhe anëtarë të tjerë të stafit, për tu përshtatur sa më mirë me ndryshimet mjaft të shpejta që pëson fusha e IT. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Në lidhje kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, IAL ka të përcaktuara në dokumentin "Rregullore mësimore e Programit të Studimit – Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile", pika 5, sipas të cilës: nota përfundimtare është shumë e elementeve të mëposhtme:<br><br>a) Provimit të ndërmjetëm (30%)<br>b) Nivelit të diskutimit (10%)<br>c) Detyrës së kursit (esse, prezantime, projekte)/dy detyra praktike |

| | |
|---|---|
| | (20%)<br>d) Provimit përfundimtar (40%).<br>Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura paraprakisht studentëve (pika 5.1 dhe 11.2). **Rregullore Mësimore e Programit të Studimit** |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Sipas RVB, studentët njihen me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës, në fillim të çdo semestri. Njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën LMS, si dhe u njoftohen me email nga koordinatorja e departamentit.<br>Gjithashtu në Rregulloren Mësimore, pika 3.1.2 dhe 3.1.4, pohohet që, në fillim të çdo semestri studentit i vihet në dispozicion programi i çdo lënde që ofrohet. Këto programe depozitohen në librarinë e Universitetit, si dhe mund të publikohen në formën e një broshure nga UET-i. Këto programe depozitohen në librarinë e Universitetit, si dhe mund të publikohen në formën e një broshure nga UET-i.<br>**Rregullore Mësimore e Programit të Studimit** |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Në dokumentin e RVB, shprehet që vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë.<br>a. Nxit studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit;<br>b. Prodhon një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim;<br>c. Shërben për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs.<br>Në Rregulloren e UET parashikohen forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive, me qëllim që pedagogu të mund të zgjedhë atë që i përshtatet më mirë natyrës së lëndës dhe evidenton më mirë rezultatet e synuara të të nxënit, të ndara këto sipas tipologjive të lëndëve. Për lëndët e Tipologjisë I janë 2 forma vlerësimi, kurse për lëndët e Tipologjisë II janë 4 forma të ndryshme vlerësimi.<br>Sipas pikës 16.5, lëndët ndahen në 2 tipologji: a. Lëndë të Tipologjisë I konsiderohen lëndët me karakter kryesisht praktik/aplikativ. b. Lëndë të Tipologjisë II konsiderohen lëndët me karakter kryesisht teorik. Kjo ndarje mendojmë që i jep mundësinë studentit që të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.<br>**Rregullore e UET** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## Standardi III.6

| Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Sipas të dhënave të reflektuara në syllabus-et e lëndëve, e në bazë të Rregullores Mësimore të Programit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit është shumë e elementëve të mëposhtëm:<br>a. Provimit të ndërmjetëm<br>b. Nivelit të diskutimit në seminare<br>c. Detyrës së kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike<br>d. Provimit përfundimtar.<br>Provimi i ndërmjetëm zhvillohet në mes të semestrit (java e 7-të ose e 8-të, sipas Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional, pika 5.3.1), seminaret janë të përjavshme, kurse detyrat e tjera janë të shpërndara sipas planit të secilit pedagog të lëndës. Kjo, për GVJ, vërteton shpërndarjen e vlerësimit përgjatë gjithë semestrit.<br>**Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Institucioni bashkëpunon me AADF (Albanian-American Development Foundation) dhe po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik: "Clean score". Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme: si në nivelin bachelor dhe master në programe të tjera studimi të IAL, por në programin Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile GVJ u informua gjatë vizitës në institucion që ende nuk është aplikuar në këtë program në ndonjë lëndë të tij. Nga njëra anë, kjo mund të jetë e kuptueshme për lëndët me karakter teknik, sic janë pjesa më e madhe e lëndëve të programit të studimit. Gjithashtu, për të rritur transparencën në vlerësim GVJ gjatë vizitës konstatoi që provimet zhvillohen duke anonimizuar studentin. Kjo realizohet duke i vendosur një barcode në cdo tezë para fillimit të provimit final. **[Vizita në IAL]** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.<br><br>**Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.<br><br>**Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ kupton që komisionet e vlerësimeve ngrihen vetëm në rastin e Praktikave Profesionale, si dhe për mbrojtjen e diplomës. Sipas RVB dhe në bazë të informacionit të marrë gjatë vizitës në IAL, në rastin e lëndëve të programit, është në gjykimin e titullarit nëse korigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë.<br><br>Gjithashtu, institucioni ndjek dhe një procedurë të mirërregulluar për rastet kur student ka ankesë për pikët e vlerësimit të lëndës. Në rastet kur këto paqartësi nuk shuhen, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e ankesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë.<br><br>Sic u përmend dhe në kriterin e mësipërm, provimet zhvillohen të sekretuara dhe të anonimizuara nëpërmjet barcode-ve. Pedagogët korrigjojnë provimet pa emrat e studentëve, derisa ato të dorëzohen në sekretarinë mësimore. Vlerësimet shoqërohen dhe me komente. Sipas RVB, cdo provim monitorohet nga dy pedagogë, sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i departamentit.<br><br>**Rregullore mesimore_MP Informatike e Aplikuar; Vizitë në IAL** |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (Rregullore e UET, Neni 33 Plagjiatura dhe kopjimi, pikat 33.1 – 33.3) GVJ konstaton që IAL ka të rregulluar rastet e evidentuara të plagjiaturës së esseve dhe diplomave, apo kopjimit në detyra. Kështu, plagjiatura e provuar në paraqitjen e esesë dhe të diplomës ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese; kopjimi nga materiale të shkruara ose nga fleta e provimit të studentëve të tjerë si edhe çdo komunikim me të tjerët gjatë orës së provimit dënohet me ndërprerjen e provimit dhe studenti vlerësohet me notën 4 (katër). Në rast përsëritjeje të plagjiaturës ose të kopjimit, emri i studentit shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe studenti paralajmërohet për përjashtim nga Universiteti.<br><br>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh dhe me programin Turnitin, të cilin IAL e ka vënë në dispozicion të gjithë stafit akademik dhe drejtues, për kontrollet e plagjiaturës<br><br>**Rregullore e UET, Neni 33 Plagjiatura dhe kopjimi; Vizita në IAL** |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.<br><br>**Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Sipas dokumentit "Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional", pika 5.3.5, dorëzimi i vlerësimeve të provimeve duhet të bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Sipas RVB, vlerësimi për kompontët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. Jo vetëm provimi përfundimtar, por ndër vlerësimet e lëndëve është dhe detyra e kursit apo esse-ja, e cila gjithashtu rregullohet në dokumentin e përmendur në këtë kriter, pika 5.6.<br><br>Për vlerësimet e vendosura nga pedagogu, sipas RVB, studenti informohet në kohë reale përmes sistemit online, si dhe për seancat |

| | |
|---|---|
| | sqaruese merr informacionit nga koordinatorja e programit.<br><br>Në lidhje me kërkesën për rishikim të vlerësimit, në rregulloren e programit, pika 5.7, studenti ka të drejtë të ngrejë një ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën.<br><br>**Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional** |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | Sipas pikës 5.7.2 të Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, studenti i cili mendon se vlerësimi nga ana e pedagogut nuk është korrekt, t'i drejtojë përgjegjësit të departamentit një kërkesë. Me marrjen e saj, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Vlerësimi i Komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procesverbalet e vlerësimit fimosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.<br><br>**Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.<br><br>**Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).<br><br>**Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | Programi i studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, sipas dokumentit "Rregullore Mësimore e Programit", ka si qëllim ta pajisë studentin me: njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit (specifikisht atë të Informatikës dhe profileve të saj); aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; formim qytetar të përgjithshëm; etj. GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë në mënyrë të kënaqshme zhvillimin e aftësive profesionale dhe të vecanta të studentëve, por sugjerojmë përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhornimin e literaturave, si dhe shtimin e trajnimeve, certifikimeve, apo vetë pjesëve praktike në lëndët e profilit,sikurse kemi evidentuar në kriteret e tjera më sipër.<br><br>Detyrat e ndryshme të kursit, projektet, literaturat ndihmëse në gjuhën angleze, mendojmë se zhvillojnë aspekte të komunikimit dhe ndërveprimit në grup. Këto detyra janë një mënyrë edhe për të analizuar kompetencat e aftësitë e studentëve e për të kuptuar më shumë nga pedagogu se cfarë ata kanë përfituar nga lënda.<br><br>**Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional; Programet lëndore** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar. | Sipas RVB, pedagogu, në orën e fundit të mësimit, përveçse ndalet edhe njëherë në çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, jep edhe orientimet e nevojshme se ku duhet të fokusohen studentët për përgatitjen e tyre në provim. Pedagogu mund të ndalet më gjatë në elementët që kanë rezultuar më të vështirë për t'u përvetësuar nga studentët, gjatë semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.<br><br>Ky komunikim mes pedagogut dhe studentëve, qartësimi i detajeve të ndryshme të lëndës, si dhe i gjithë procesi mësimor u vërtetua dhe nga vizitës në institucion nga GVJ, ku studentët u shprehën mjaft të kënaqur.<br><br>**Vizita në IAL** |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Sipas RVB, personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit si orë të klubit të IT apo pjesë të forumeve e ëorkshopeve të ndryshëm, ku studentët kanë mundësinë e zgjerimit të dijeve dhe prezantimit me risi të reja në fushën ku ata studiojnë. Kjo u bë e ditur edhe gjatë vizitës në institucion, ku GVJ u informua nga drejtuesit e njësisë bazë.<br><br>**Vizita në IAL; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm** |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Në programin Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, lëndë të caktuara të programit zhvillohen në laboratorët e informatikës, ku studentët e këtij masteri anën teorike të leksioneve të marra e zbatojnë praktikisht. Kjo u konstatua nga GVJ gjatë vizitës në IAL.<br><br>Praktika profesionale është një lëndë e programit të studimit, e cila kryhet në pozicione pune sa më pranë fushës së studimit të programit, me synim rritjen e aftësive profesionale dhe integrimin më të mirë në tregun e punës.<br><br>**Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional; Vizita në IAL; Tabele Permbledhese te Praktikes Profesionale MP** |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Sipas RVB dhe e konfirmuar gjatë vizitës në institucion, puna në grup dhe diskutimet janë një pjesë shumë e rëndësishme në UET për arritjen e objektivave mësimore pasi sa më shumë ide të shpalosen nga studentët aq më e thjeshtë bëhet të kuptuarit e leksionit dhe zgjidhja e problematikave të caktuara.<br><br>**Vizita në IAL** |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. | Programi mësimor i Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, në lëndët e tij ka krijuar një klimë të mirë për zhvillimin e ideve innovative e kjo lidhet ngushtë me vetë natyrën që programi ka. Duke qenë i orientuar drejt profileve informatike, me natyrë të aplikuar, pjesa e studimeve të avancuara kërkimore e shkencore nuk mbulohet nga ky program në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këto profile i shohim që IAL i ka si focus në programe të tjera studimi, të cilat studentët e Masterit |

| | |
|---|---|
| | Profesional mund t'i ndjekin në përfundim të tij.<br><br>Një inkurajim i mirë që i jepet studentëve është për të marrë pjesë në projekte të ndryshme të shkëmbimit si ai Erasmus+.<br><br>**Te dhena mbi trajnimet profesionale_Qendra e Teknologjise dhe Inovacionit; Vizita në IAL** |
| **Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | GVJ konstaton, gjatë takimit me përfaqësuesit e IAL, që angazhimi i studentëve në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare është një pjesë e rëndësishme e jetës universitare. Shumë prej tyre kanë përfituar dhe nga programet e shkëmbimit, si ai Erasmus+. Në lidhje me studimet e avancuara kërkimore e shkencore apo mbështetja financiare e tyre, kjo nuk evidentohet në dokumentet e dorëzuara nga IAL.<br><br>Në RVB përmendet që në shkurt 2019, institucioni ka realizuar aktivitetin Shkolla Dimërore e Inovacionit. Ky program (bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion), i drejtohet gjimnazistëve dhe synimi i ketij projekti është përmirësimi i përfshirjes sociale të të rinjve ekonomikisht të pafavorizuar, të rinjve në rrezik, kryesisht gjimnazistë të cilët kontribuojnë me ide inovative në fusha të ndryshme si: inxhinieri, arkitekturë, teknologji, por jo për studentët e IAL, apo punën e tyre kërkimore-shkencore.<br><br>**Te dhena mbi trajnimet profesionale_Raport mbi aktivitetin Durres Shkolla Dimerore; Vizita në IAL** |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | UET mbështet këshillat e studentëve nga ana logjistike dhe mund të financojë projekte të tyre. Gjithashtu, evidentohet se një pikë e fortë e institucionit tonë është bashkëpunimi shumë i suksesshëm falë zyrës së projekteve ku mundësohet shkëmbimi i studentëve në nivel ndërkombëtar nëpërmjet programave Erasmus, projekt ky që ka funksionuar shkëlqyer e më së miri në gjithë tërësinë e tij. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Sikurse përmendëm në kriteret më lart, studentët e programit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, zhvillojnë tema të caktuara në ambjentet laboratorike të institucionit. Për tu ambjentuar dhe me mjedisin real të punës, ata zhvillojnë dhe praktikat profesionale në formën e internship pranë institucioneve, me të cilët IAL ka marrëveshje.<br><br>**Tabele Permbledhese te Praktikes Profesionale MP; Marreveshje Bashkepunimi mes UET dhe X** |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave | Pranë institucioneve ku studentët akordohen për të kryer praktikat, ata njihen me format dhe teknologjitë e përdorura në tregun e punës |

| | |
|---|---|
| klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | shqiptar, me qëllim përfitimin sa më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale që lidhen me këtë fushë në të cilën ata po studiojnë, si dhe për të orientuar dhe kualifikimin e tyre professional përtej studimeve të ciklit të dytë. |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Sipas pasqyrës të Programit mësimor lënda Praktika profesionale ka 6 ECTS. Sipas Rregullores Mësimore të Programit Master Profesional, janë të detajuara rregullat që duhet të shoqërojnë zhvillimin e Praktikave Profesionale. Sipas pikës 34.2 të këtij dokumenti, praktikat profesionale vlerësohen me notë, njëlloj si detyrimet e tjera. Vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet përpara një komisioni.<br><br>**Rregullore mesimore_MP Informatike e Aplikuar** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.9**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton që institucioni harton rregullore të posacme për provimin final apo atë të mbrojtjes së diplomës. Kështu, këto saktësohen në dokumentet: (1) B.II. Mbi punimin e diplomës/disertacionit; (2) Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional; si dhe në Rregullore e UET. Sipas RVB, ky informacion i vihet në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua që përcaktimin e diplomës apo provimit, departamenti e bënte në bazë të mesatares së ciklit të parë. Argumenti për këtë zgjidhje ishte kohëzgjatja një-vjecare e programit master në fjalë.<br><br>**Mbi punimin e diplomës/disertacionit; Rregullore Mësimore e Programit Master Profesional; Rregullore e UET** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Sipas RVB, studentët e programit Masterit Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, në përfundim të studimeve të tyre realizojnë një punim diplome në formën e rastit studimor, rast krahasues ose projektit kërkimor (për studentët me mesatare mbi 7.5, ose i nënshtrohen një provimi përfundimtar, në formën e rastit studimor kompleks, të lidhur me profilin përkatës të studimit.<br><br>Gjithashtu departamenti ofron tek studentët dokumentacionin udhëzues në lidhje me përmbushjen e këtij detyrimi konform përcaktimeve në rregullore. Seancat metodologjike të zhvilluara në mënyrë të dedikuar gjatë semestrit të dytë të programit, i ndihmojnë studentët të kuptojnë edhe më mirë mënyrën e zhvillimit të punimit/provimit si dhe mbrojtjes së diplomës.<br><br>**Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; Rregullore mesimore_MP** |

| | Informatike e Aplikuar |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Në bazë të RVB, institucioni ka vendosur që për programin Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile, duke qenë se fokusi i programit është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit, edhe provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë pikërisht aftësitë e studentëve për të aplikuar në një rast studimor njohuritë e përfituara nga programi i studimit. Nga IAL, ritestimi teorik i njohurive është gjykuar i papërshtatshëm për një program të llojit Master Profesional, me kohëzgjatje 1 vit.<br><br>**Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; Vizita në IAL** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Në dokumentin B. II. Mbi punimin e diplomës/disertacionit, pika B. II. 2.1 – B. II.2.4, GVJ konstaton mënyrën e përcaktimit të temave të diplomave për programet me karakter professional. Në fillim të muajit tetor, çdo Departament organizon mbledhjen e Bordit të Tregut të Punës për të konsultuar tematikat e ndryshme, që mund të shërbejnë si objekt studimi në nivel diplome, si edhe për të identifikuar udhëheqësit potencialë të këtyre studimeve. Më pas, cdo anëtar i personelit akademik, brenda muajit tetor, njofton/përditëson fushat e tij të ekspertizës dhe ofron propozime konkrete për tema diplome ku është i gatshëm të udhëheqë studentë, duke mundësuar krijimin e një inventari me tema diplomash. Së fundmi, studenti plotëson formularin e aplikimit në konsultim paraprak me një pedagog dhe e dorëzon atë brenda afatit të shpallur. Në rast të mosrespektimit të afatit, studentit i shtyhet tema për në sezonin tjetër.<br><br>Orientimi i studentëve vazhdon dhe pas zgjedhjes së temës për cdo vështirësi që mund të hasë studenti.<br><br>Institucioni vë në dispozicion të studentëve të gjitha kapacitetet e tij logjistike dhe infrastrukturore, si biblioteka, laboratorët si dhe asistencën e vazhdueshme të pedagogut udhëheqës.<br><br>**Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit;** |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Sipas dokumenteve të vëna në dispozicioni, si dhe RVB, udhëheqësi në seancat metodologjike duhet të trajtojë çështje të tilla si: (a) përcaktimin shkencor të objektit të studimit; (b) diskutimin e dobisë së punimit; (c) përzgjedhjen e tematikës dhe të problematikës që do të trajtohet; (d) Ndërtimin e hipotezave dhe saktësimin e tyre; etj. Pra, udhëheqësi shihet se ka një rol kyc në mbarëvajtjen e procesit të diplomës, si dhe në garantimin e cilësisë duke u kujdesur që të ndiqen parimet dhe metodat e duhura shkencore. Në mbyllje të punimit, studenti e dorëzon tek udhëheqësi, i cili e miraton ose jo atë. Një student nuk mund të mbrojë diplomën nëse ai nuk ka shlyer të gjitha detyrimet, si dhe nëse nuk ka mbrojtur praktikën, pra nevojitet formimi i tij i plotë teorik dhe praktik, para se të kalohet në diplomë apo provimin përfundimtar të ciklit të dytë.<br><br>**Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; Vizita në IAL; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Sipas dokumentit B. II, si dhe në bazë të Rregullores Mësimore të Programit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Studenti që merr notë jokaluese në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezulton mbetës, studenti duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome.<br>**Rregullore mesimore_MP Informatike e Aplikuar** |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, GVJ evidenton formatin e diplomës, si dhe suplementin e saj. Sipas Rregullores së UET, student që ka plotësuar të gjitha detyrimet, pajisjet nga institucioni brenda 6 muajsh me diplomën përkatëse, bashkë me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve. Studenti pajiset me to në përmbyllje të studimeve. Formati i diplomës dhe suplementi i saj janë dokumente të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Ky fakt është i shprehur në dokumenacionin e vënë në dispozicion, por mungon një dokument mbështetës në lidhje me vendimin e ministrisë përgjegjëse.<br>**Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; Model diplome; Suplementi diplomes** |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në Rregulloren e UET (pika 40.1), GVJ konfirmon që në përfundim të studimeve vihet në dispozicion të studentëve diploma, suplementi i diplomës dhe certifikata e notave. Programi i studimit përmendet ne Suplementin e diplomes si pjese e aneksit 1. Ky aneks nuk gjendet i bashkengjitur ne supplement ne dokumentacionin e dorezuar nga IAL. |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen. | Sipas RVB, por edhe nga vizita e kryer në institucioni, GVJ konstatoi që institucioni ruan duke magazinuar për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse ato kërkohen. Nga depozitimet përkatëse të dokumentacioneve mund të gjendet në çdo moment një kopje respektive duke verifikuar zbatimin e rregullores në çdo pike. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1** Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se nga zyra e Burimeve Njerëzore, si njësia përgjegjëse janë mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) të angazhuar me programin Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile dhe janë krijuar dosje personeli për secilin prej tyre. Gjatë vizitës dhe takimit me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore u vlerësuan dosjet e personelit akademik të tre anëtarëve të personelit akademik të angazhuar me programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile përkatësisht E.K dhe M.D (PAE) dhe P.K (PAK).<br><br>GVJ konstaton se nga kjo zyrë janë mbajtur dhe ruajtur të dhëna për angazhimin e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) në programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile për vitet 2013-2020. Në një evidencë të veçantë janë regjistruar të dhënat për stafin akademik të njësisë kryesore /bazë për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020.<br><br>GVJ konstaton se nga institucioni janë paraqitur në nivel institucioni, statistikat e personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me 5 profile.<br><br>**"11 Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerezore", "44 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Plotë" dhe "44.1 Format Dosje, Staf Akademik me Kohë të Pjesshme". "23 Të dhëna Tabelore për personelin akademik _Fakulteti i Inxhinierise, Informatikes dhe Arkitektures", "23.1 Te dhena tabelore per personelin akademik_Fakulteti ekonomik dhe IT", "23.1.1 Fakulteti i Ekonomise, Biznesit dhe Zhvillimit", "24 Stafi akademik i programit MP Informatike e Aplikuar", "Personeli akademik i departamentit 2019-2020" dhe "Stafi akademik i programit 2019-2020".** |
| **Kriteri 2** Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se procedurat e rekrutimit të personelit akademik në Universitetin Europian të Tiranës janë rregulluar me rregullore të veçantë, në përputhje me detyrimet e akteve ligjore në fuqi. Në procesin e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik janë të përfshirë dhe drejtuesi i njësisë bazë dhe sipas rastit pedagogë, si dhe ekspertë të jashtëm të fushave përkatëse për programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. Procedurat e ndjekura për procesin e rekrutimit në Universitetin Europian të Tiranës janë përcaktuar në procedurat e rekrutimit të stafit të ri akademik në rregulloren në fuqi. |

| | |
|---|---|
| | **"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, pika 22", "11 Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerezore, pika G I" dhe "6 Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit".** |
| **Kriteri 3** Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se në rregulloren e zyrës së burimeve njerëzore janë parashikuar procedura dhe kritere specifike të punësimit të personelit akademik të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar, me 5 profile të cilat propozohen nga drejtuesi i njësisë bazë të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile dhe miratohen nga rektori i Universitetit Europian të Tiranës, si dhe procedura që ndiqet është e hapur nëpërmjet publikimit të vendeve vakante në faqen zyrtare të Universitetit Europian të Tiranës, rrjete sociale dhe në gazetën Liberale.<br>**"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, pika 22" dhe "11 Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerezore, pika G I", "6 Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit", "11.1 Shembull thirrje për staf akademik" dhe Faqja zyrtare e UET http://uet.edu.al/neë/thirrje-aktuale-per-punesim/".** |
| **Kriteri 4** Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se në procedurën e ndjekur nga Universiteti Europian të Tiranës për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik janë plotësisht të përfshirë departamenti i njësisë bazë, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile nëpërmjet paraqitjes së kërkesës dhe kritereve të përgjithshme dhe të posaçme për plotësimin e vakancës/vakancave në përputhje me modulet dhe përmbajtjen e programit dhe kualifikimin e personelit të kërkuar.<br>**"11 Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerezore, pika G I".** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se është ndërmarrë angazhimi i duhur dhe është krijuar një mjedis dhe infrastrukturë e përshtatshme për realizimin e detyrave në mënyrë profesionale nga personeli i institucionit. GVJ vizitoi ambientet e Universitetit "Europian të Tiranës", dy nga tre godinat e veçanta me një sipërfaqe totale afro 11 |

| | |
|---|---|
| | 500 m2, në funksion të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. Në përdorim të personelit të angazhuar me programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile janë vënë në dispozicion zyra me hapësira të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (kondicionim, ndricim dhe postë të pajisura me kompjuter personal)<br><br>Ngarkesa totale javore e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile për vitin e paraqitur 2018 - 2019 është një ngarkesë vjetore mesatarisht prej afro 10 orë mësimore në javë/ çdo semestër, ku përfshihen dhe angazhimet në programet e tjera të studimit duke u lënë në dispozicion kohën e nevojshme për kualifikime të mëtejshme apo për kërkimin shkencor. Ndërkohë për vitin akademik 2019-2020 , në informacionin e vënë në dispozicion, pas vizitës në IAL, mungon informacioni për angazhimin dhe ngarkesën e personelit akademik në programe të tjera studimi. |
| | **"42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit". "24 Stafi akademik i programit MP Informatike e Aplikuar", " 25 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik , MP Inf. Aplikuar" dhe " Stafi akademik i programit 2019-2020"** |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se Universiteti Europian të Tiranës në funksion të një ndër objektivave kryesorë të misionit të tij "2 Statusi i UET, neni 6.3", atë të mbështetjes së zhvillimit dhe kualifikimin e mëtejshëm të personelit dhe arritjen e ekselencës në të gjitha fushat ka zhvilluar dhe mbështetur stafin akademik në aktivitete akademike dhe të kërkimit, të organizuara nga Universiteti Europian të Tiranës apo në bashkëpunim me institucione të tjera, si në vend dhe jashtë tij. Disa aktivitete dhe nisma që UET ka ndërmarrë në këtë drejtim janë: zhvillimi i trajnimeve mbi metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja, përfshirja e stafit akademik projektet e financuara nga donatorë të ndryshëm, dhe me partnerë nga vendet e BE-së dhe rajoni, shkëmbimi i stafit akademik në kuadër të marrëveshjeve, skema e financimit të kërkimit shkencor, duke krijuar një fond prej 75.000 Euro për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara në Thomson Reuters dhe së fundmi një nismë e re për krijimin e një grupi kërkimor ndërdisiplinor nga 10 profesorë, për të cilët është vënë në dispozicion një fond vjetor, prej 5.000 euro për secilin.<br><br>Ngarkesa e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile është mesatarisht prej 10 orë mësimore në javë/ çdo semestër, ku përfshihen dhe angazhimet në programet e tjera ju mundëson kohën në dispozicion për kualifikime të mëtejshme dhe kërkimin shkencor. |
| | **"43 Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit akademik", "43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS", "43.2 Agenda for HRS4R Training 12-13 October 2018", "43.3 Të dhëna mbi shkëmbimin e stafit", "53** |

| | |
|---|---|
| | **Projekti 250+", "55.1 Outgoing staff _programe", "55.2 Incmoming staff _ study programms" dhe "56 DSSH 2019". "24 Stafi akademik i programit MP Informatike e Aplikuar" dhe " 25 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik , MP Inf. Aplikuar".** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se nga ana e institucionit është zbatuar parimi i angazhimit të burimeve njerëzore, personelit akademik në këtë program inovativ, sipas ekspertizës në mësimdhënie dhe në fushën specifike, në funksion të përmbushjes së programit së studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile.<br><br>**"CV e stafit të programit", "24 Stafi akademik i programit MP Informatike e Aplikuar" dhe " Evidenca 25 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik , MP Inf. Aplikuar".** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile në funksion të veprimtarisë mësimdhënëse. Auditorët e vënë në dispozicion për pjesën teorike të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile janë të kapaciteteve të ndryshme dhe të pajisur me kompjuter, videoprojektor dhe dërrasë interaktive.<br><br>**"42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit".** |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për programin në funksion të veprimtarisë mësidhënëse. Auditorët, klasa, laboratorët, bibloteka, sallat e leximit, si dhe ambientet e tjera në funksion të mësimdhënies - mësimnxënies në programin e studimit Master |

| | |
|---|---|
| bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile janë të pajisura me pajisje elektronike (kompjuter, videoprojektor, dërrasë interaktive, pajisje fotokopjimi dhe printimi) dhe janë të mbështetura me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit si:<br>• Katër salla laboratorësh të pajisur me kompjuter (mbi 30 kompjutera) me akses në intranet dhe internet.<br>• Studentët, personeli akademik dhe administrativ kanë akses të plotë në rrjetin LAN dhe Ëi-Fi të Universitetit "48 Infrastuktura IT";<br>• Sistemin MOODLE (UET LMS), ku studenti në kohë reale azhornohet me materialet mësimore, mund të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët dhe kolegët dhe mund të informohet për vlerësimin e secilës lëndë.<br>• Kompjutera me performancë të lartë dhe me softëare përkatës të instaluar, në ambjentet laboratorike për programin e studimit: Navicat for my SQL; NetBeans; Apache Tom Cat; SPSS 19, CAD, si dhe laboratori "Inovation Hub".<br>• Bibloteka online SAGE dhe EBSCO, me abonim 5 vjecar institucional dhe QUESTIA.<br>Të gjitha ambientet mbështeten nga infrastruktura qëndrore dhe e hostuar TIK që administrohen të gjitha nga personeli TI i Universitetit Europian të Tiranës.<br>**"46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS", " Evidenca 46.2 UET LMS - Guide per pedagogun", "46.3 UET_LMS_ Guide per studentet" dhe "43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS, Maj 2019"; "42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit"** |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të procesit mësimor të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile 4 laboratorë me videoprojektor, dërrasë interaktive, pajisje fotokopjimi dhe printimi, si dhe mbi 30 kompjutera për secilin laborator, me akses në intranet dhe internet, të cilat mirëmbahen nga personeli TI i Universitetit Europian të Tiranës dhe programet përditësohen sipas kërkesës nga departamentet përkatëse. Gjithashtu në dispozicion të këtij programi është laboratori "Inovation hub", i cili është në dispozicon të studentëve të programit për projekte dhe detyra të disa lëndëve të programit të studimit. Studentët, personeli akademik dhe administrativ kanë akses të plotë në rrjetin LAN dhe Ëi-Fi të Universitetit.<br>**"42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit".** |
| **Kriteri 4.** Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion 4 laboratorë me mbi 30 kompjutera secili me akses në një rrjet të përbashkët dhe internet. Në kompjuterat me performancë të lartë të |

| | |
|---|---|
| | laboratorëve janë të instaluara disa programe që përdoren për disa lëndë të programit të studimit si: Navicat for my SQL; NetBeans; Apache Tom Cat, SPSS 19,CAD.<br><br>**"42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit".** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni, përveç infrastrukturës së tij, në funksion dhe mbështetje të garantimit të mjediseve të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale e programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile bashkëpunon në zbatim të marrëveshjeve të nënshkruara të bashkëpunimit me disa institucione dhe organizata. Studentët e këtij programi studimi Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile janë akomoduar dhe kanë zhvilluar praktikat mësimore pranë institucioneve dhe organizatave bashkëpunuese.<br><br>**"34-34.8 Marreveshje Bashkepunimi mes UET dhe institucione/ organizata", " 32 Tabelë Përmbledhëse të Praktikës Profesionale MP".** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton që bibloteka është e lokalizuar në godinën e vecantë C, me një sipërfaqe 300 m2, në dispozicion dhe të studentëve të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile gjatë orarit 9.00-20.00, nga e hëna deri të premten dhe të shtunën 9.00-17.00. Bibloteka mund ta shfrytëzohet si sallë leximi për literarurën fizike, nga 150 studentë dhe është e pajisur me kompjutera (14) dhe akses të pakufizuar në internet, nëpërmjet të cilëve studentët mund të aksesojnë bibliotekat online SAGE (abonim 5 vjeçar), EBSCO (abonim 5 vjeçar), dhe QUESTIA, në të cilat UET është abonuar.<br><br>**"42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit".** |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se në bibliotekën e institucionit disponohet për programet e studimit, një koleksion librash me literaturë fizike në shqip dhe gjuhë të huaj në një fond të përgjithshëm për të gjithë programet e studimit prej 6005 librash (4634 në shqip dhe 1371 në gjuhë të huaj) dhe 61 libra për programin e studimit "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile shumica në gjuhën angleze, si dhe cikli i |

| | |
|---|---|
| të studimit. | leksioneve në shqip për pjesën më të madhe të lëndëve në gjuhën angleze, të programit të studimit. “45 Inventari i teksteve”. Literatura e programit të studimit azhornohet nëpërmjet pasurimit të biblotekës nëpërmjet kërkesës dhe plotësimit të formularit përkatës për blerjen e literaturës në bibliotekë, si dhe aksesit ne biblotekat online të abonuara nga institucioni.<br><br>**“42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit”** |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se për studentët e programit të studimit Master Profesional “Informatikë e Aplikuar”, me 5 profile ofrohet shërbimi falas dhe me akses të barabartë në katalogun e librave elektronik të biblotekës, shumica në gjuhë të huaj dhe biblotekat online të abonuara nga institucioni si SAGE (abonim 5 vjeçar), EBSCO(abonim 5 vjeçar) dhe QUESTIA, në intranetin e biblotekës.”42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit”. Në të njëjtën kohë, studentët aksesojnë në internet dhe përdorin sistemin MOODLE (UET LMS), ku studenti në kohë reale azhornohet me materialet mësimore.<br><br>**”43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS, Maj 2019”, “46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS”, “ Evidenca 46.2 UET LMS - Guide për pedagogun” dhe “46.3 UET_LMS_Guide për studentët”.** |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se bibloteka është e pajisur me pajisjet dhe programet kompjuterike nëpërmjet të cilëve studentët shfrytëzojnë pa kufizime:<br><br>• Katalogun e librave elektronik të biblotekës, shumica në gjuhë të huaj;<br>• Biblotekat online të abonuara nga institucioni si SAGE (abonim 5 vjeçar), EBSCO (abonim 5 vjeçare) dhe QUESTIA, në intranetin e biblotekës;<br>• Sistemin MOODLE (UET LMS), ku studenti në kohë reale azhornohet me materialet mësimore.<br><br>**“42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit” , “46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS”, “ Evidenca 46.2 UET LMS - Guide për pedagogun”, “46.3 UET_LMS_ Guide për studentët” dhe “43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS, Maj 2019”.** |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se në biblotekën e institucionit disponohet për programet e studimit, një koleksion librash në literaturë fizike në shqip dhe gjuhë të huaj në një fond të përgjithshëm për të gjithë programet e studimit prej 6005 librash (4634 në shqip dhe 1371 në gjuhë të huaj) dhe 61 libra për programin e studimit “Informatikë e Aplikuar”, me 5 profile shumica në gjuhën angleze, si dhe cikli i |

| | |
|---|---|
| | leksioneve në shqip për pjesën më të madhe të lëndëve në gjuhën angleze, të programit të studimit. Nga ana e departamentit, fakultetit dhe institucionit duhet të hartohet dhe zbatohet një plani detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin të atij ekzistues, në përputhje më përmirësimet e syllabuseve të lëndëve të programeve të studimit.<br><br>**"45 Inventari i teksteve"** |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve shërbimet e bibliotekës çdo ditë gjatë orarit 9.00-20.00, nga e hëna deri të premten dhe të shtunën 9.00-17.00. Bibliotekën mund të shfrytëzojnë si sallë leximi në të njëjtën kohë 150 studentë."**42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit"** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni disponon dhe ka në përdorim sistemin UMIS nëpërmjet të cilit menaxhohet informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre, në të gjithë programet e studimit, përfshirë dhe në programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. Ky sistem mundëson gjenerimin e raporteve dhe informacioneve të nevojshme lidhur me aktivititetin e studentëve.<br><br>**"46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS".** |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton që institucioni përdor sistemin e brendshëm të menaxhimit, një zgjidhje sharepoint për të administruar informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, të personelit ndihmës akademik dhe/apo personelit administrativ dhe partnerëve të përfshirë në realizimin e programit. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton që institucioni përdor për administrimin e dokumentacionit të institucionit në lidhje me programin e studimit sistemin/aplikacionin e intranetit të brendshëm, një sistem i përshtatur, mbi zgjidhjen sharepoint, nëpërmjet së cilës mundësohet administrimi i |

| | |
|---|---|
| | informacionit sipas hierarkisë dhe roleve të autorizuara të përshtatur për përdorimin nga stafi adminstrativ, akademik dhe ndihmës akademik. Ndërkohë institucioni për administrimin e informacionit dhe literaturës së lëndëve të personelit akademik dhe të studentëve të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile ka vënë në përdorim sistemin Moodle UET LMS, që ka të regjistruar dhe të përditësuar informacionin e nevojshëm për lëndët e programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile për çdo semestër, akses në literaturën e lëndëve, si dhe pedagogët përgjegjës për lëndët.<br><br>**"43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS, Maj 2019", "46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS", "46.2 UET LMS - Guide për pedagogun" dhe "46.3 UET_LMS_Guide për studentët"** |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni ka në funksion të plotë dy platforma/sisteme LMS dhe UMIS për realizimin dhe administrimin e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet stafit akademik, personelit administrativ dhe studentëve. Sistemi i menaxhimit me platformat e integruara LMS ose UMIS mundëson forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve në mënyrë të saktë, në çdo kohë dhe në distancë. Në platformën LMS organizohet dhe administrohet procesi, materialet dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve nga pedagogu në funksion të zhvillimit të procesit të mësimdhëmies dhe mësimnxënies. Informacioni administrohet në formë të personalizuar për çdo përdorues, pedagog apo student.<br><br>**"43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS, Maj 2019", "46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformës LMS", "46.2 UET LMS - Guide për pedagogun" dhe "46.3 UET_LMS_Guide për studentët" dhe "46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS".** |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton që institucioni monitoron në kohë reale aktivitetin akademik dhe administrativ nëpërmjet përdorimit të sistemeve/ platformave UMIS dhe UET LMS, që mundësojnë raportime individuale dhe në kohë reale për/nga organet drejtuese dhe titullarët. Sekretaria mësimore gjeneron në kohë reale, raporte individuale për secilën lëndë për organet drejtuese dhe titullarët.<br><br>**"43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS, Maj 2019", "46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS", "46.2 UET LMS - Guide për pedagogun" dhe "46.3 UET_LMS_Guide për studentët" dhe "46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS".** |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni ka në funksion platformën e faqes zyrtare Ëeb, një faqe dinamike në të cilën publikohet informacion |

| | |
|---|---|
| është gjuha shqipe | mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, fakulteteve, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, ato të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacioni i publikuar azhornohet në mënyrë të vazhduar dhe në dy gjuhë.(gjuha shqipe dhe angleze).<br>**Faqja zyrtare e UET http://uet.edu.al".** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **x** |

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar projektbuxhetin afatmesëm 2018-2020 dhe ka ndjekur zbatimin faktik të buxhetit. Institucioni ka hartuar raportin financiar në lidhje me koston për secilin program studimi, për çdo vit akademik dhe ka regjistruar dhe ruajtur të dhëna krahasuese për ecurinë dhe vazhdimësinë financiare të institucionit, për vitet 2013-2018, duke mundësuar identifikimin e komponentëve kryesore që ndikojnë në performancën e institucionit dhe që garantojnë qëndrueshmëri dhe rezultate financiare për institucionin. Institucioni ka burim kryesor financimi tarifat për dhe gjatë shkollimit, pasi të ardhurat nga aktivitetet e tjera tregtare si: qeradhënie, parkim etj zënë një pjesë të vogël të tyre. Gjatë viteve 2013-2018 është shtuar dhe burimi i financimit nga grantet e kërkimit, të akorduara nga projekte të ndryshme me donatorë të huaj, ku UET merr pjesë,të cilat zënë një pjesë të vogël, në krahasim me tarifat për dhe gjatë shkollimit. Kjo evidentohet dhe në raportet e paraqitura për të ardhurat, financimin dhe menaxhimin e burimeve financiare të programeve të studimit për vitet 2013-2018, si dhe konstatohet shpenzimet dhe kosto e studimit në rritje për student dhe për vit akademik të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile, përkatësisht për vitet 2015-2018.<br>**"2 Statusi UET, Kreu VIII Financimi","37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018", "49. Të dhëna mbi koston për student" dhe "50. Të ardhura dhe financime të ndryshme".** |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni harton planin e financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare në përputhje me standardin |

| | |
|---|---|
| shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | e hartimit të raportimit financiar dhe të evidentimit të kostos së studimit. Institucioni harton pasqyra financiare në transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe plani financiar i paraqitur për financimin e programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile parashikon financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe infrastrukturës mbështetëse të procesit mësimor, detyrimet financiare të institucionit, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.<br><br>**"49. Të dhëna mbi koston për student" dhe "50. Të ardhura dhe financime të ndryshme"."37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018", "49. Të dhëna mbi koston për student" dhe "50. Të ardhura dhe financime të ndryshme"** |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.<br><br>**Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka kryer auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2018, nga një auditues ligjor i pavarur, sipas raportit vjetor në lidhje me transparencën financiare që paraqesin aspektet materiale dhe pozicionin financiar të kësaj shoqërie në datën 31 Dhjetor 2018. Eksperti ka përgatitur raportin përkatës që depozitohet pranë QKR–së, konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare. Nga audituesi është nxjerrë konkluzioni se pasqyrat financiare paraqesin drejt aspektet materiale dhe pozicionin financiar të kësaj shoqërie në datën 31 Dhjetor 2018, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara në Shqipëri. Në këto pasqyra konstatohet se burimi i të ardhurave të institucionit janë pagesat nga tarifat për dhe gjatë studimit, grantet për kërkim dhe kontratat.<br><br>**"Raporti Auditues.pdf11_20_2019" dhe "37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018"** |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet pasqyrave financiare të raportuara për vitin 2018, të çertifikuara dhe nga audituesi ligjor i autorizuar ka patur burim të të ardhurave të institucionit pagesat nga tarifat për dhe gjatë studimit, grantet për kërkim dhe kontratat. Plan buxheti hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm, zbatimi faktik i të cilit i ngarkohet administratorit dhe zyrës së financës. Të gjitha veprimet janë të rregulluara nëpërmjet autorizimit nga administratori i zyrës financiare për kryerjen e veprimeve vetëm nëpërmjet sistemit bankar. **["Raporti Auditues. pdf11_20_2019" dhe "37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018".** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni ka hartuar, miratuar dhe zbaton politika dhe procedura që duhet të ndjekë për programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile dhe që janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi "Udhëzimi Nr.18, datë 21.5.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në vitin akademik 2018-2019", i ndryshuar, Kreu IV/4 dhe IV/5" dhe të përcaktuara në Statusin dhe Rregulloren e Institucionit, rregulloren e Fakultetit të Informacionit dhe Inovacionit, si dhe rregulloren e veçantë të Programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile<br>**"2 Statusi i UET, Kreu IV Studimet Universitare" , "5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Kreu IV Studimet Universitare" dhe "7 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, neni 3 Programi i Studimit".** |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar, miratuar dhe zbaton politika dhe procedura për të garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student dhe studentët e programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile, që mbështeten në Statusin e Institucionit, Rregulloren e e Universitetit Europian të Tiranës, si dhe rregulloren Mësimore e Programit të Studimit.<br>**"2 Statusi i UET, Kreu IV Studimet Universitare", "5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Kreu IV Studimet Universitare" dhe "7 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, neni 3 Programi i Studimit".** |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konfirmon se në zbatim të politikave dhe procedurave të |

| | |
|---|---|
| ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Institucionit ka përdorur një sërë mjetesh dhe metodash bashkëkohore për publikimin e kritereve dhe procedurave të aplikimit, pranimit dhe regjistrimit të studentëve, procesit të vlerësimit të dijeve si dhe diplomimit të studentëve të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. Kriteret dhe procedura e aplikimit janë publikuar përpara fillimit të vitit akademik në faqen zyrtare të institucionit, në fushatat informuese mediatike të zhvilluara në shkolla të mesme të ndryshme jo vetëm të Tiranës, broshurat informuese (Guida UET), si dhe gjatë procesit të informimit dhe këshillimit në zyrat përkatëse në Institucion.<br><br>**"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Kreu IV Studimet Universitare", "7 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, neni 3 Programi i Studimit", "27.1 Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve","28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin", "48 Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online", "51 Komunikimi i integruar i marketingut" dhe http://uet.edu.al/neë/si-te-aplikojme/".** |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.<br><br>**Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se në përcaktimet rregullatore të IAL janë përcaktuar vetëm kriteret e përgjithshme të pranimit të studentëve në programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. Sipas rregullores së programit të studimit në fjalë, dekanati vendos nëse ka kritere specifike akademike për pranimin e studentëve. GVJ konstaton se nuk janë hartuar dhe publikuar kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në këtë program studimi. Kriteret e përgjithshme për pranimin janë publikuar në faqen zyrtare të ëeb të UET dhe u është komunikuar para fillimit të vitit akademik studentëve dhe të interesuarve në zyrat përkatëse të institucionit.<br><br>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ ka konstatuar se institucioni përpara fillimit të vitit për programin e studimit "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile ka informuar dhe udhëzuar publikun dhe studentët e interesuar për kriteret e përgjithshme për pranimin në programin e studimit nëpërmjet informimit në faqen ëeb të institucionit, fushata informuese në shkollat e mesme jo vetëm në Tiranë, fushat publicitare në televizione, broshurave të informimit (GUIDA UET), si dhe informimit të publikut të interesuar dhe në zyrat dhe ambientet e institucionit.<br><br>**"Udhëzimi Nr.18, datë 21.5.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në vitin akademik 2018-2019", i ndryshuar, Kreu IV/4 dhe IV/5", "5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Kreu III "Pranimi i studentëve", neni 11 "Kriteret e pranimit"" dhe "7 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, neni 2 "Pranimi në programin e studimit"", "27.1 Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit te studenteve","28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin" ,"48 Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online", "51.** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Komunikimi i integruar i marketingut" dhe http://uet.edu.al/neë/si-te-aplikojme/" | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se për programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Në javën e parë të orientimit të organizuar nga fakulteti, gjatë orientimit dhe prezantimit të syllabusit të lëndës, nga çdo pedagog, në javën e parë të mësimit.<br><br>**"7 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, neni 2 "Pranimi në programin e studimit"","28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin", "14.1 Plani mësimor MP Informatike e Aplikuar","10.1 Kalendari Akademik 2018-2019" dhe "Syllabuse të lëndëve të programit të studimit".** |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni në zbatim të Udhëzimit Nr.18, datë 21.05.2019, të ndryshuar të MASR, ka parashikuar procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme në rregulloren e programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. Gjatë vitit akademik 2014-2015 janë transferuar në UET 2 studentë dhe në vitin 2017-2018 janë transferuar në UET 6 studentë.<br><br>**"7 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, neni 2 "Pranimi në programin e studimit"", "27 Te dhena per regjistrimin, ecurine dhe diplomimin dhe "28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin".** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve të programit të studimit, për infrastrukturën në dispozicion të programit, në javën e orientimit dhe në mënyrë specifike gjatë prezantimit të secilës lëndë dhe syllabusit përkatës ku paraqitet ky informacion.<br><br>GVJ konstaton se institucioni ka të përcaktuar në rregulloren |

| | |
|---|---|
| | universitetit, të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile dhe programin mësimor procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit, e cila organizohet si punim diplome apo provim i përgjithshëm formimi. Në takimin me studentët u informuam që në vitin akademik 2018-2019 është vendosur në mes të vitit kriteri penalizues i mesatares së studimeve Bachelor për zgjedhjen e punimit të diplomës, për të cilën studentët duhet të ishin informuar para fillimit të studimeve.<br><br>**"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Kreu VI "Programi i studimit","7 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, neni 3 "Programi i studimit" ,"14 Programi_MP Informatikë e Aplikuar", me 5 profile "10 Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit" dhe "10.1 Kalendari Akademik 2018-2019"."Syllabuse të lëndëve të programit të studimit".** |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni publikon informacionin në mënyrë periodike mbi programin e studimit, Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile në faqen zyrtare të internetit të institucionit, nëpërmjet fushatave të vazhdueshme të publicitetit, botimit dhe shpërndarjes së broshurave informuese(GUIDA UET) dhe informacionit të dhënë gjatë vizitave të të interesuarve në institucion. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve ka organizuar takime të hapura me studentët në auditore, ku është bërë prezantimi i programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile dhe mundësitë reale të studentëve për tu përzgjedhur në këto programe, është ndarë informacioni për mundësitë në tregun e punës për këtë program studimi dhe bursat që ofron institucioni, ku për vitin akademik 2018-2019 janë dhën 3 bursa, një e plotë dhe 2 në masën 50 %.<br><br>**"7 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, neni 2 "Pranimi në programin e studimit"", "27.1 Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit te studenteve", "28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin" ,"48 Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online", "51 Komunikimi i integruar i marketingut", "39.1 Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik", "Të dhëna për bursat MP Informatikë e Aplikuar", Dok DVV 48 Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online" dhe http://uet.edu.al/neë/si-te-aplikojme/"** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile si dhe për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtarisë formuese. Përveç këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit dhe kontakteve me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, në javën e parë të orientimit, në zbatim të rregullores së programit të studimit, krahas prezantimit të të gjithë elementëve të programit të studimit nga përgjegjësi i departamentit të njësisë bazë dhe stafi akademik, realizohet prezantimi i objektivave, njohuritë dhe aftësitë që do të fitohen nga secila lëndë. Në javën e parë të mësimit në secilën lëndë bëhet prezantimi i detajuar i lëndës, përmbajtja dhe veprimtaritë formuese të parashikuara. Me këtë informacion studentët njihen dhe në faqen zyrtare të informacionit, broshurave informuese (Guida UET) dhe syllabuset e lëndëve.<br><br>**"7 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit", "27.1 Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve","28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin", "48 Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online", "51 Komunikimi i integruar i marketingut", "35 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit", "39.1 Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik" "10.1 Kalendari Akademik 2018-2019", "Syllabuse të lëndëve të programit të studimit" dhe http://uet.edu.al/neë/"** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se struktura specifike e institucionit, Zyra Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit është struktura që zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim më këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillon, mbështet dhe orienton studentët e programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile për tregun e punës nëpërmjet Bordeve të tregut të punës, organizimit të panairëve të punës dhe aktiviteteve me partnerë dhe aktorë nga tregu i punës. Studentët gjatë vitit akademik 2018-2019, janë udhëzuar dhe kanë përfituar nga marrëveshjet me institucione private dhe shtetërore për praktika mësimore dhe janë ftuar dhe në trajnime dhe aktivitete të përbashkëta të realizuara. Në mënyrë të vazhdueshme studentët e programit të studimit janë informuar për mundësi të ndryshme punësimi me email dhe janë mbështetur dhe këshilluar për përgatitjen e CV, letrave të motivimit, përgatitjen për intervistë punësimi.<br><br>**"12 Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit", "12.1 Poster panairi i punes 2019", "32 Tabelë Përmbledhëse e Praktikës Profesionale M", "33. Te dhena mbi trajnimet profesionale", "33.1 Të dhena mbi trajnimet profesionale_Qendra e Teknologjisë dhe Inovacionit", "33.2 Të dhëna mbi trajnimet** |

| | |
|---|---|
| | **profesionale_Raport mbi aktivitetin Durres Shkolla Dimerore", "35 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit", "34-34.8 Marrëveshje Bashkëpunimi mes UET dhe Institucionet/organizat" dhe http://uet.edu.al/neë/dita-e-biznesit-ne-uet".** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni informon studentët nëpërmjet burimeve të ndryshme mbi organizmin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastukturën mbështetëse, si dhe shërbimet e ofruara nga institucioni në funksion të realizimit të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. Që në javën e parë të orientimit studentët njihen nga departamenti. Në mënyrë specifike koordinatori i departamentit ka detyrë informimin e vazhdueshëm dhe të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e programit mësimor, logjistikës, infrastrukturës së programit të studimit Çdo ndryshim apo përditësim u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatorëve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve. Nga ana tjetër çdo informacion mbi procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, njoftohen përmes postës elektronike dhe sistemit Moodle UET LMS.<br><br>**"36 Vendimi emerimit te koordinatorit te programit", "36. 1 Detyrat e koordinatorit te programit te studimit", "10.1 Kalendari Akademik 2018-2019", "46.3 UET_LMS_Guide për studentët", "43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS, Maj 2019", "48 Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online" dhe http://uet.edu.al/neë/"** |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se Informacioni mbi programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile është lehtësisht i aksesueshëm nga çdo student i këtij programi, nëpërmjet platformës Learning management System (LMS) në UET, ku studentët kanë mundësi të gjejnë materialet përkatëse të të gjitha lëndët në të cilat janë regjistruar si dhe ndërveprojnë lehtësisht me stafin pedagogjik për çdo paqartësi. Kjo platformë është përshtatur si aplikacion mobile dhe aksesohet në distancë nga studentët.<br><br>**"46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS","46.3 UET_LMS_Guide për studentët" dhe "43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS, Maj 2019".** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të |

| | |
|---|---|
| studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. | Tiranës", GVJ konstaton se në sekretarinë mësimore të institucionit mbahen dhe regjistrohen të dhëna vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile.<br><br>Në këtë program studimi janë regjistruar për vitin 2019-2020, **34 studentë** në total dhe sipas profileve:<br>▪ "Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh" **9 studentë**,<br>▪ "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh" **3 studentë**,<br>▪ "Menaxhim të Dhënash" **8 studentë**,<br>▪ "Siguria e Sistemeve të Informacionit" **13 studentë**<br>▪ "TV – Multimedia" **1 student**.<br><br>Të dhënat për numrin e studentëve të regjistruar janë dhënë për të gjitha vitet e programit të studimit 2012-2020, të dhënat për numrin e studentëve të diplomuar janë dhënë për vitet 2012-2018.<br><br>**"5 Regjistrimet 2019-2020" dhe "27 Të dhëna për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin".** |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se siç u cilësua dhe në kriterin e parë, institucioni disponon të dhëna vjetore për studentët e regjistruar në programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile apo që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër . Në këtë program studimi që nuk ka pasur tërheqje apo largime nga ky program studimi.<br><br>**"27 Të dhëna për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin".** |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ evidentoi pas vlerësimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sekretaria mësimore gjatë vizitës se IAL kryen regjistrimin e ecurisë së studentëve të programit të studimit në procesverbalët përkatës dhe regjistrin e notave. GVJ konstaton se institucioni regjistron dhe disponon të dhëna në sekretarinë mësimore për ecurinë e studentëve të programit të studimit Master Profesional "Informatikë e aplikuar", me 5 profile nga pranimi deri në përfundim të studimeve. Këto të dhëna statistikore përdoren nga universiteti, fakulteti apo departamenti për analiza të ndryshme.<br><br>**"27 Të dhëna për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin" dhe "9 Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarise Mesimore".** |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se siç është cilësuar edhe më parë në raport, sekretaria mësimore për menaxhimin e informacionit të brendshëm përdor sistemin e menaxhimit të informacionit të universitetit (UMIS) që është një program informatik ku ruhen, administrohen dhe përpunohen të |

| | |
|---|---|
| | gjitha të dhënat e studentëve, përfshirë dhe rezultatet e ecurisë në programin e studimit, gjenerimin e raporteve të ndryshme statistikore. Këto të dhëna dhe raporte shërbejnë për administrimin e aktiviteteve e institucionit sipas roleve dhe aksesit të autorizuar.<br><br>**"46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS" dhe "9 Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore".** |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Europian të Tiranës", GVJ konstaton se institucioni ka hartuar për studentët e programit të studimit Master Profesional "Informatika e aplikuar", në vitet akademik 2012-2018, një raport analitik mbi profilin, cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe nivelin dhe cilësinë e punësimit të tyre. Në kuadër të masave për përmirësimin e treguesve të punësimit të studentëve Zyra e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit e cila ndjek karrierën dhe punësimin e studentëve në vazhdimësi mban kontakte me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre, vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, pranë Universitetit Europian është krijuar që në 2009, Shoqata "UET ALUMNI" e cila është aktive në shumë aktivitete të rëndësishme të institucionit si mbledhja e fondeve, aplikimet për projektet dhe propozime për përmirësime të programeve aktuale dhe të reja që krijojnë hapësira dhe tregje të reja pune.<br><br>**"27 Te dhëna për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin", "17. Studim periodik për tregun e punës" dhe "12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit".** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.5<br>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka parashikuar në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vëndimarrëse e këshilluese, përkatësisht në statusin dhe rregulloren e institucionit, ku specifikohet qartë përfshirja, angazhimi, si dhe roli i Këshillit studentor, përfshirja dhe angazhimi i përfaqësueve të studentëve në organet vendimarrëse e këshilluese të institucionit.<br><br>**"5 Statuti Universiteti Europian të Tiranës, Kreu VII Studentët, neni 51" dhe "5. Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Kreu X Të drejtat dhe detyrimet e studentit".** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka garantuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vëndimarrëse e këshilluese nëpërmjet përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit, përkatësisht në statusin dhe rregulloren e institucionit. Studentët përfaqësohen përkatësisht në senatin akademik, komisionet e përhershme, këshillin e etikës dhe në Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC)"<br><br>**37.4 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_2017-2022", "5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Kreu X Të drejtat dhe detyrimet e studentit", "6 Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit", "8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë" dhe "30 Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC".** |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar planin mësimor të përgatitur për programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile në zbatim të VKM Nr.41, datë 24.01.2018 duke mbajtur në fokus ngarkesën akademike të studentëve në këtë program studimi sipas përcaktimeve. Gjatë vitit akademik 2014-2015 janë transferuar në UET 2 studentë dhe në vitin 2017-2018 janë transferuar në UET 6 studentë.<br><br>**"VKM Nr.41, datë 24.01.2018" dhe "11 Programi mësimor", "28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin dhe "27 Të dhëna për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin".** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se në këtë program studimi, Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile se është realizuar proces i rishikimit dhe përmirësimit deri në 20 % të këtij programi studimi me Vendimin e Senatit Akademik Nr.7 të datës 14.06.2018 që është dërguar për njohje pranë MASR sipas përcaktimeve ligjore me shkresën me Nr.149.Prot, datë 27.07.2019, me lëndë "Kërkesë për miratimin e riorganizimit dhe përshtatjes së programeve në ciklin e parë dhe të dytë studimeve".<br><br>**"VKM nr. 41 date 24.01.2018 Per elementet e programeve të studimit te ofruara nga IAL-të", "Kthim përgjigje_Miratimi i Përshtatjeve 2" "14 Programi_MP Informatikë e Aplikuar ", "14.1 Plani mësimor MP Informatikë e Aplikuar" dhe "Rishikimi i kurrikulës" dhe "37 Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve".** |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni u mundëson studentëve së pari vënien në dispozicion dhe informimin mbi kriteret dhe procesin e vlerësimit të dijeve në programin e studimit, Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile në javën e informimit dhe gjatë |

| | |
|---|---|
| nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | javës së parë të mësimit për çdo lëndë. Studentëve ju mundësohet nëpërmjet procedurave të rregulluara e drejta e barazisë dhe transparencës në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve, si dhe mundësisë së ankimimit të rezultatit, kërkesës për rishikim të tij.<br><br>**"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës Neni 24, 27 dhe 32", "Rregullore Mësimore e Programit të Studimit" dhe "40.1 D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve _ Departamenti".** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton procedura të veçanta, të përcaktuara që në rregulloren e institucionit, si dhe ka ngritur njësinë përgjegjëse për informimin dhe në shërbim të studentëve, që është Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (ZKKKS) me objektiva dhe detyra të mirëpërcaktuara.<br><br>**"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës", "12 Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit", "39.1 Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik", "51 Komunikimi i integruar i marketingut" dhe "37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018".** |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se ZKKKS funksionon tërësisht në mbështetje të informimit, këshillimit, ndjekjes së përparimit të studentëve dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit, Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. Krahas saj institucioni zhvillon këshillimin e karrierës në fushatën "Gjimnaz Tour" dhe tour-in e këshillimit pegagog-maturant, në periudhën Gusht - Shtator, ku përvec këshillimit për programet e studimit, ofrohet informacioni për jetën studentore, aktivitetet e ndryshme që zhvillohen gjatë vitit akademik në UET, tarifave edhe modaliteteve të pagesës, si dhe bursat e ofruara nga UET. Më tej me regjistrimin e studentëve në programin e studimit, ky proces ndiqet nga ZKKKS. Një nga programet me interes që prezantohet nga ZKKKS është programi ERASMUS+ dhe mobiliteti në universitetet e tjera me të cilat universiteti ka bashkëpunim.<br><br>**"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës", "12 Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit", "37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018" "29 Të dhëna për punësimin e studentëve", "51 Komunikimi i integruar i marketingut". dhe** |

| | |
|---|---|
| | **"32 Tabelë Përmbledhëse e Praktikës Profesionale MP".** |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet ZKKKS ka ofruar shërbimin e këshillimit të karrierës dhe kujdesin ndaj studentit, në bashkëpunim të ngushtë me qeverisjen studentore kanë mbështetur studentët në mënyrë të vazhduar, duke i orientuar qoftë në drejtim të përfundimit me sukses të procesit mësimor, por dhe në orientimin dhe zgjedhjen e praktikës profesionale, si dhe orientimin në tregun dhe vendet e lira të punës, mbështetjen dhe këshillimin e nevojshëm në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe përgatitjen për intervistë. Krahas kësaj zyre ofrohet tutoriati dhe këshillimi akademik për studentët nga personeli akademik. Nga kjo zyrë janë krijuar kontakte dhe institucioni ka lidhur marrëveshje me kompani private dhe institucione shtetërore në funksion të praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit të studentëve. Çdo departament ka bordin e tij të tregut të punës, ku studentë të shoqatës ALUMNI janë pjesë e tyre. Në UET organizohet në formë asambleje 2 herë në vit takimi i bordeve të të tregut të punës në funksion të përmirësimit të procesit dhe programit mësimor. Në fund të vitit akademik 2018-2019 u organizua eventi i radhës për "Panairi i punës", me pjesëmarrjen e shumë kompanive private me interes për studentët e programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. Ndërkohë ZKKKS ka udhëzuar dhe mbështetur studentët mbi mundësitë e mobilitetit me projektin ERASMUS+ dhe projektet e tjera të institucionit, si dhe mundësitë e punësimit me Biznesin.<br><br>**"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës", "12 Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit", "37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018", "51 Komunikimi i integruar i marketingut" dhe "53 Projekti 250+".** |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se ZKKKS, si pjesë e detyrave të përcaktuara në rregulloren e kësaj zyre ndjek dhe mbështet studentët e diplomuar në programin e studimit, duke grumbulluar, përpunuar dhe regjistruar të dhënat mbi punësimin dhe cilësinë e punësimit të tyre në raport me programin e studimeve. Në UET është krijuar prej 10 vjetësh shoqata ALUMNI, ku studentët nëpërmjet procedurës dhe formularit së regjistrimit mund të bëhen pjesë e saj. Në 10 vjetorin e saj u akordua çmimi special për personin më të suksesshëm. Nga UET janë organizuar aktivitete të rëndësishme si ALUMNI SIPËRMARRËS dhe ALUMNI INTERNATIONAL, ku pjesëmarrja arrin deri në 15-20 % të studentëve. Institucioni ka bashkëpunim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e saj në funksion të sugjerimeve për përmirësimet e nevojshme të ofertës akademike të institucionit për tiu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve teknologjike në vend e jashtë.<br><br>**"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës", "12 Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj** |

| | |
|---|---|
| | Studentit", "37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018" "29 Të dhëna për punësimin e studentëve" dhe http://uet.edu.al /neë/uet-alumni-10-vite-me-pas/". |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni harton dhe zbaton politika, ka ngritur struktura dhe procedura, në përputhje më aktet ligjore në fuqi dhe ato rregullatore të institucionit. Misioni i arsimit të lartë është të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane. Struktura përgjegjëse e ngritur për këtë qëllim është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. KSBC është një strukturë autonome dhe e perhershme në strukturën organizative të institucionit përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. KSBC është ngritur në nivel universiteti dhe anëtarët e tij propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit. Gjithashtu në UET është ngritur dhe është funksionale një strukturë tjetër që prej vitit 2016, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC) për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit.<br>"Ligji nr. 80 2015, datë 22.07.2015, Nenet 1, 38 dhe 103" dhe "2 Statusi i UET, Nenet 11 dhe 16" "5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 6" dhe "37.4 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_2017-2022", "8 Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë", "37.3 Plani i Veprimit_ KSBC_2018-2019" dhe "37.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë". |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe |

| | |
|---|---|
| dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka ngritur strukturën përgjegjëse, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që është një strukturë autonome, e perhershme dhe funksionale në strukturën organizative të institucionit që nga viti 2011. Kjo njësi zbaton strategjinë në funksion të objektivave të institucionit që ka në fokus kryesor përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë në këtë process ekspertë të jashtëm, si dhe përfaqësues të studentëve. KSBC monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike proceset mësimore e kërkimore në UET. Nga 2016 është ngritur dhe është funksionale një strukturë tjetër, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC) për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. Për këtë qëllim institucioni ka hartuar dhe zbaton strategjinë, planin e veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë.<br><br>**"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, neni 6", "37.4 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_2017-2022", "8 Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë", "37.3 Plani Veprimit_ KSBC_2018-2019", "37.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë" dhe "30 Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC".** |
| **Kriteri 3.** Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni në zbatim të statutit, planit strategjik dhe rregullores së tij ka anagazhuar përvec strukturave përgjegjëse dhe ato bashkëpunuese, si dhe instrumente efektive për sigurimin e cilësisë si: personelin akademik dhe ndihmës akademik, Bordet e Tregut të Punës, përfshirja në KSBC i një eksperti të jashtëm dhe përfaqësuesit të këshillit studentor.<br><br>Universiteti Europian i Tiranës në 5 vitet e fundit ka kaluar të dy format e procesit të akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit, në mënyrë specifike Akreditimi Institucional nga ASCAL i cili ka përfunduar më datë 12.05.2017, me vlerësimin përfundimtar pozitiv, i vlefshëm deri më 06.04.2022 (5 vite akademike) si dhe programeve të studimit.<br><br>**"5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, neni 6", "37.4 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_2017-2022", "8 Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë", "37.3 Plani Veprimit_ KSBC_2018-2019", "37.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë".dhe "30 Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC". "Vendim Nr.46 date 05.07.2019 Për Akreditimin e UET" dhe "Vendimi i BA Nr. 12 datë 07.04.2017_akreditimi periodik institucional".** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të |

| | |
|---|---|
| ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një politikë dhe strategji të qartë, për të ndjekur në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, procedura periodike që garantojnë dhe përmirësojnë cilësinë e programeve të studimeve, në këtë rast Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile.<br><br>Strukturat përgjegjëse kanë përdorur instrumentat e duhura në zbatim të strategjisë dhe manualit të miratuar të sigurimit të brendshëm të cilësisë, sipas një plani kaledarik, kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit dhe takimeve të zhvilluara me palët e interesuara. Disa nga instrumentet e përdorur, për monitorim dhe vlerësim, në zbatim të planit të veprimit, për monitorimin e cilësisë së programit të studimit dhe mësimdhënies janë:<br>1. Pyetsorin studentor online dhe anonim për cilësinë e mësimdhënies në çdo program studimi 2 herë në vit ;<br>2. Monitorimi i procesit mësimor, në javën e 12-të të çdo semester, me anë të fokus grupeve, që formohen me studentë të rastësishëm të programit të studimit dhe drejtohen nga KSBC.<br>3. Monitorimi i realizimit të procedurës së provimeve, praktikës mësimore apo diplomës, nëpërmjet grupeve ad-hoc, në bashkëpunim me departamentin përkatës;<br>4. Monitorimi dhe përmirësimi i kurrikulave apo syllabuseve të lëndëve, nëpërmjet grupeve ad-hoc në bashkëpunim me departamentet përkatës;<br>5. Monitorimi dhe përmirësimi i programeve të studimit, nëpërmjet grupeve ad-hoc në bashkëpunim me departamentet përkatës;<br><br>KSBC, në kuadër të SBC, në mënyrë periodike informon drejtuesit e njësive, mbi rezultatet dhe raportet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me objektiv marrjen e masave për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofrohen nga institucioni.<br><br>**"5 Statuti UET, nenet 11 dhe 16", "7 Plani Strategjik 2016-2020" dhe "37.4 Strategjia per Sigurimin e Brendshem te Cilesise_2017-2022", "18 Rekomandimet nga akreditimi i mëparshëm", Dok DVV Evidenca 19.1 A-III-8-2 Indikatorët e vlerësimit të programit të lëndës", "35. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkepunimit", "37 Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve", "40 G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët" dhe "41 G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik" dhe "40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve _ Departamenti".** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| |
|---|
| **Standardi VI.2** |
| **Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë** |

| periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se Universiteti Europian të Tiranës ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një njësi të posaçme me funksion të përhershëm, e cila është funksionale dhe është përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen e programeve të ciklit të dytë. Gjithashtu në UET është ngritur prej vitit 2016 dhe është funksionale një strukturë tjetër, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC) për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit.<br><br>Këto njësi përdorin mekanizma e procese të formalizuara të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e hërëpashershme të programit të studimeve të ciklit të dytë, përfshirë dhe Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile në zbatim të strategjisë, planit të veprimit dhe manualit të miratuar, sipas një plani kaledarik, kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit dhe takimeve të zhvilluara me palët e interesuara.<br><br>Dy herë në vit, organizohen në mënyrë anonimate, 2 javë para përfundimit të aktivitetit mësimor semestral, pyetsorët online studentor për cilësinë e mësimdhënies në çdo program studimi, përfshirë edhe programi i studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. NJBSC përgatit dhe vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar, raportin e vlerësimeve periodike në procesin e shqyrtimit, miratimit dhe mbikëqyrjes së programeve të studimit në rang institucional. Në fund të vitit njësia bazë për programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile realizon procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë së këtij programi studimi. Rezultatet e vlerësimit dhe sipas rasteve të identifikuara për përmirësim përkthehen në rekomandime për tu zbatuar dhe monitoruar më tej për përmirësimin dhe mbarëvajtjen e ecurisë së këtij programi.<br><br>"37.4 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_2017-2022", "8 Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë", "37.3 Plani Veprimit_ KSBC_2018-2019", "37.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë" dhe "30 Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC". "18 Rekomandimet nga akreditimi meparshëm", Dok DVV Evidenca 19.1 A-III-8-2 Indikatorët e vlerësimit të programit të lëndës", "39 Dokumenti A.III Mbi parimet e ndertimit te programit te lendes", "35 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkepunimit", "37 Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve", "40 G-III-4-2 Formati i vlerësimit të |

| | |
|---|---|
| | pedagogut nga studentët" dhe "41 G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik" dhe "40.1 D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve _ Departamenti". "52. Rishikimi i kurrikulës" dhe "38 Analizë vjetore e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MPInformatikë e Aplikuar", me 5 profile. |
| **Kriteri 3.** Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka përdorur metodologji vlerësimi dhe instrumente të vlerësimit të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, përfshirë dhe programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. KSBC ka organizuar aktivitete për procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor me mbështetjen e grupeve ad-hoc të ngritura pranë departamenteve. Rezultatet e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të programeve të studimit raportohen tek drejtuesit e institucionit dhe fakulteteve, ku jepen dhe rekomandimet përkatëse për tu zbatuar, zbatimi i të cilëve ndiqet dhe monitorohet nga strukturat drejtuese dhe vetë KSBC.<br><br>**"37 Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve", "40 G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët" dhe "41 G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit të performancës së personelit akademik" dhe "40.1 D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve _ Departamenti". "15.5 Vlerësimi i Cilësisë Pyetësori i Studentëve", "52. Rishikimi i kurrikulës" dhe "38 Analizë vjetore e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile.** |
| **Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni dokumenton rezultatet e vlerësimeve, të cilat i ka raportuar tek autoritetet përgjegjëse dhe vendimarrëse të programit të studimit. Raporti i rezultateve të nxjerra nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të programeve të studimit raportohen nga KSBC tek titullari i lëndës përgjegjësve të grup-lëndëve, drejtuesit të departamentit, dekani, së bashku me rekomandimet përkatëse, zbatimi i të cilëve ndiqet dhe monitorohet nga strukturat drejtuese dhe vetë KSBC.<br><br>**"37 Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve", "38 Analizë vjetore e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MP Informatikë e Aplikuar" dhe ""52 Rishikimi i kurrikulës".** |
| **Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni për aktivitetet e monitorimit dhe të vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit ka përgatitur raporte të cilat përmbajnë rezulatet e vlerësimit, masat e marra për adresimin e mangësive të identifikuara |

| | |
|---|---|
| | dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e tyre.<br><br>**"37 Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve", "38 Analizë vjetore e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MPInformatikë e Aplikuar" dhe ""52 Rishikimi i kurrikulës".** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.<br><br>**Kriteri 2**. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni, nëpërmjet KSBC realizon vlerësimin e brendshëm periodik të programit të studimit, Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile, në nivel institucional, me mbështetjen e departamentit që mbulon programin e studimit, i cili është pjesë e procesit të vetëvlerësimeve të kryera në kuadër të akreditimeve apo vetëvlerësimet e brendshme periodike.<br><br>Universiteti Europian i Tiranës gjatë vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta, si dhe mjete specifike, në përputhje me specifikat e fushës së programit të studimit. Një instrument shumë efektiv i përdorur është përfshirja e studentëve në proceset e vlerësimit të programit të studimit, Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile, ku një përfaqësues i Këshillit të Studentëve është pjesë e KSBC. Instrumentet kryesore e përdorur gjatë vlerësimit janë pyetsorët online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve.<br><br>**"37 Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve", "38 Analizë vjetore e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MPInformatikë e Aplikuar" dhe ""52 Rishikimi i kurrikulës". 40 G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët" dhe "41 G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit te performancës së personelit akademik" dhe "40.1 D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve _ Departamenti" dhe "15.5 Vlerësimi i Cilësisë Pyetësori i Studentëve".** |
| **Kriteri 3.** Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit, Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile ka përdorur disa metoda të drejtpërdrejta vlerësimit si më poshtë: |

| | |
|---|---|
| vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | 1. Teste të standartizuara;<br>2. Vrojtime në orët mësimore në auditor;<br>3. Vrojtime gjatë kryerjes së praktikës;<br>4. Vlerësimi i detyrave apo projekteve individuale apo në grup;<br>5. Rezultatet e studentëve në provime të lëndëve të programit të studimit të vlerësuara me pike dhe notë;<br>**"19.1 A-III-8-2 Indikatorët e vlerësimit të programit të lëndës", "37 Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve", "40 G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët" dhe "41 G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik" dhe "40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve_ Departamenti".** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit ka përdorur metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi të tilla si sondazhet për vlerësimin e mësimdhënies (lëndëve dhe pedagogëve) në programin e studimit, sondazhe të kurrikulës, infrastrukturës në dispozicion, si dhe intervista me studentët e programit të studimit. Raportet e rezultateve të vlerësimit u raportohen drejtuesve të institucionit, fakulteteteve dhe rektoratit të institucionit, si dhe në mënyrë individuale i raportohen dhe personelit akademik pjesë e procesit të vlerësimit. Këto rezultate vlerësimi reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në fund të vitit akademik. Një fokus i veçantë i kushtohet intervistave me pedagogët gjatë procesit të vlerësimit të performancës së tyre.<br>**"37 Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve", "40 G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët" dhe "41 G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit të performancës së personelit akademik" dhe "40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve_ Departamenti".** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe garanton që në |

| | |
|---|---|
| cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | zbatimin e politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë të përfshihen aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile. Në KSBC janë angazhuar përvec personelit të brendshëm të institucionit, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i këshillit studentor. Ngritja e bordeve të tregut të punës dhe bashkëpunimi i KSBC me to ka ndikim pozitiv të vazhdueshëm në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit. Përfshirja e institucionit në dy projekte europiane si: projekti UET – ENCHASE TEMPUS<br><br>"Përforcimi i sistemit të sigurimit të cilësisë së brendshme në arsimin e lartë në Shqipëri: Aplikimi i metodologjisë të bazuar kah procesit dhe rezultateve" për periudhën kohore Dhjetor 2013– Dhjetor 2016 dhe projekti Erasmus+ QainAL" Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në institucionet private të Arsimit të Lartë në Shqipëri (QAinAL)" për periudhën kohore 2016-2019, që kanë në fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë kanë impakt pozitiv që lidhet në mënyrë të veçantë përtej shkëmbimit të eksperiencave, njohurive nëpërmjet trajnimeve dhe vizitave studimore , me vlerësimin dhe përmirësimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve të përdorura nga IAL-të private për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë. **"37.4 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm te Cilësisë_2017-2022", "37.3 Plani Veprimit_ KSBC_2018-2019", "30 Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC", "37.5 Fisha e projektit Enchase" dhe "37.6 Fisha e projektit QAinAL".** |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.<br><br>**Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për KSBC, njësitë, personelin akademik, personelin administrativ, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, përfshirë Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile duke garantuar përgjegjshmëri në ushtrimin e detyrave. Aktivitetet e planifikuara për vitin akademik 2018-2019 janë paraqitur në planin e veprimit të KSBC, janë në funksion të objektivave të strategjisë për sigurimin e brendshëm të Cilësisë 2017-2022, me objektiv madhor sigurimin e cilësisë të procesit mësimor në programin e studimit, Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile si dhe kërkohet pjesëmarrja aktive në propozimin, përcaktimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të modeleve vlerësuese sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.<br><br>**"37.4 Strategjia per Sigurimin e Brendshem te Cilesise_2017-2022", "8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë", "37.3 Plani Veprimit_KSBC_2018-2019", "37.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë", dhe "30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC".** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.<br><br>**Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka përfshirë dhe aktivizuar në KSBC personel akademik të brendshëm nga të gjitha fakultetet, që nuk janë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET, si dhe një përfaqësues të këshillit studentor të përzgjedhur në një proces tërësisht transparent. Këta aktorë të brendshëm janë pjesëtar aktivë të procesit të vlerësimit të brendshëm në nivel institucioni dhe programi studimi në bashkëpunim dhe me njësinë bazë që mbulon programin e studimit. Ndërkohë përfshirja e ekspertit të jashtëm në proceset e vlerësimit është vetëm në nivel institucioni dhe jo në nivel programi studimi.<br><br>**"37.4 Strategjia per Sigurimin e Brendshem te Cilesise_2017-2022", "8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë", "37.3 Plani Veprimit_KSBC_2018-2019", "37.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë", dhe "30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC".** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe strategji për organizimin dhe aktivitetet në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni, për vitin 2018-2019 është paraqitur plani i veprimit të KSBC dhe ka bërë publike vetëm një pjesë të tyre për studentët dhe të gjithë të interesuarit, në faqen zyrtare të institucionit (Statuti i UET dhe raportet e vlerësimit të programeve të studimit për vitet 2009-2014).<br><br>**"2. Statusi i UET", "37.4 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_2017-2022", "8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë", "37.3 Plani Veprimit_KSBC _2018-2019","37.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë", http://uet.edu.al/neë/statuti/?lang=sq" dhe http://uet.edu.al/ neë/raporte-vleresimi/?lang=sq"** |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni, pas përfundimit të procesit të vlerësimit ka përgatitur rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit, përfshirë dhe Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile që duke i konsideruar të dhëna sensitive dhe personale i ka ndarë përgjithsisht, në grupet që kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe në raste të veçanta kur të dhënat janë konsideruar se kanë një sensibilitet të lartë janë trajtuar nga strukturat drejtuese ne takime individuale. Nga institucioni janë bërë publike sipas rekomandimit, të dhënat e rezultateve të vlerësimit SBC për programin e |

| | |
|---|---|
| | studimit vetëm për vitet 2012-2014.<br><br>**“2. Statusi i UET”, “37.4 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_2017-2022”, “8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”, “37.3 Plani Veprimit_KSBC _2018-2019”,”37.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë”, “37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018” dhe http://uet.edu.al/ neë/raporte-vleresimi/?lang=sq“.** |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni në raportet e përgatitura pas nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit, ka evidentuar një plan masash që duhet të ndërmerren nga grupet dhe aktorët e përfshirë dhe interesuar për të arritur objektivin e përmirësimit të mangësive të identifikuara. Rezultatet e marra nga procesi i vlerësimit periodik janë përdorur jo vetëm për vlerësimin e procesit dhe identifikimin e problematikave, por edhe me objektiv marrjen e masave për përmirësimin e garantimin e cilësisë së brendshme të programeve të studimit.Disa nga masat e marra në drejtim të përmirësimit të cilësisë janë: trajnimet e vazhdueshme mbi metodat e sukseshme didaktike në mësimdhënie dhe kërkim shkencor; mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen dhe përfshirjen në aktivitete dhe projekte zhvilluese edhe jashtë institucionit, në Shqipëri dhe jashtë.<br><br>**“37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018”, “33.1 Të dhëna mbi trajnimet profesionale_Qendra e Teknologjisë dhe Inovacionit”, “41 G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit te performancës së personelit akademik”, “43 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin”, “43.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS, Maj 2019”, “43.2 Agenda for HRS4R Training 12-13 October 2018”, “43.2 Agenda for HRS4R Training 12-13 October 2018”, “53 Projekti 250+”, “55.1 Outgoing staff _programe”, “55.2 Incmoming staff _ study programms”, “56 DSSH 2019” dhe “26 Institucionet bashkëpunuese me Europian të Tiranës”.** |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se institucioni, ka vlerësuar dhe siguron monitorim të vazhdueshëm të procesit të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit. Ky proces vlerësimi dhe monitorimi ka pasur objektiv kryesor sigurimin e efektivitetit dhe impaktit të masave të marra për përmirësimin e mangësive dhe problematikave të identifikuara gjatë procesit të vlerësimeve periodike dhe të sigurojë përmirësimin e cilësisë të programeve të studimit.<br><br>**“2. Statusi i UET”, “37.4 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_2017-2022”, “8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”, “37.3 Plani Veprimit_KSBC _2018-2019”,”37.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë”, “37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018” dhe “18 Rekomandimet nga akreditimi mëparshëm”.** |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Europian të Tiranës, GVJ konstaton se Universiteti Europian të Tiranës, ka përfshirë stafin akademik dhe studentët në proceset e sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në KSBC dhe pjesëmarrjes në GVB ad-hoc të programeve të studimit në proces |

| | |
|---|---|
| programit të studimit | akreditimi, në javën e orientimit në fillim të vitit akademik dhe në mënyrë të tërthortë dhe me procesin e pyetësorëve të studentëve.<br><br>Institucioni duhet të organizojë veprimtari periodike me studentët për ti informuar në mënyrë të drejtpërdrejtë studentët për nevojën e ndergjegjësimit të tyre për rëndësinë e pjesëmarrjen aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm dhe afatgjatë të cilësisë në programin e studimit Master Profesional "Informatikë e Aplikuar", me 5 profile.<br><br>**"2. Statusi i UET", "37.4 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_2017-2022", "8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë", "37.3 Plani Veprimit_KSBC _2018-2019","37.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë", "37.1 UET_Raporti Vjetor 2017-2018","40.1 D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve _ Departamenti","38. Analizë vjetore e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MPInformatikë e Aplikuar".** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Informatikë e Aplikuar" me profile: a) Dizenjim dhe zhvillim aplikimesh; b) Menaxhim të dhënash; c) Siguria e sistemeve të informacionit; d) TV-Multimedia; e) Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh, të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Europian të Tiranës"

### Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat për hapjen e programeve të studimit që ndikojnë nëzhvillimin ekonomik të vendit. Kështu, plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar në drejtimin e Teknologjisë së Informacionit.
2. Programi i studimit gëzon mbështetje të mirë nga strukturat drejtuese dhe kjo vihet re nga projektet ndërkombëtare, mbështetja nga Bordi i Punës, apo mundësitë e ofruara për studentët.
3. Institucioni ka një sistem të konsoliduar të kontrollit të cilësisë në mësimdhënie.
4. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor.
5. Rritja e bashkëpunimit dhe pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare ka ofruar dhe mbështet personelin akademik dhe studentët në njohuri dhe eksperiencë në fusha dhe projekte me interest të programit të studimit dhe tregut të punës.
6. Institucioni ka zhvilluar mekanizma specifikë për mbështetjen dhe kualifikimin profesional të personelit akademik në funksion të metodave bashkëohore të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare.

7. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të reja në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit.
8. Ofrimi i mbështetjes së studentëve me anë të bursave dhe programet e mobilitetit, ndërkombëtarizimit për studentët me rezultate të larta apo pjesëmarrjes dhe trajnimit në aktivitete dhe trajnime profesionale të organizuara nga UET dhe organizata profesionale apo kompani private

## Pika të dobëta

1. Programi i studimit shpreh paqartësi në hartimin e qëllimeve dhe objektivave të tij. Vërehet një kompaktësi e munguar në dokumentacionet, kur përcaktohen këto elemente të rëndësishëm të programit të studimit. Këto mangësi reflektojnë paqartësi dhe në vlerën e diplomës në treg, për profesionet e mundshme.
2. Raportet e përcaktuara për personelin akademik me kohë të plotë/student, ku personeli akademik duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore, plotësohen vetëm në 2 prej 5 profileve, përkatësisht "Dizenjim dhe zhvillim aplikimesh" dhe "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh".
3. Personeli i punësuar me kohë të plotë që është i angazhuar me mësimdhënie në tre prej profileve, për lëndët me natyrë teknike, është i pakët në numër dhe i paqëndrueshëm nga një vit akademik në tjetrin.
4. Programi i studimit duhet të ketë më tepër konsistencë ne kurrikulat brenda secilit profil, për të qartësuar kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët.
5. Përzgjedhja e lëndëve të profileve, përshkruhet se i përputhet tregut të punës, por mungon përafrimi me programe të ngjashme studimi të ofruara nga institucione arsimore ndërkombëtare.
6. Dokumentacioni i analizës vjetore të programit të studimit duhet të realizohet në mënyrë të plotë dhe shteruese, duke ndjekur metodologjinë e duhur. Këtu do të nxirreshin në pah dhe efektet në punësim të diplomës, ndërtimi i strukturës mësimore, qartësia e programit, etj.
7. Njësia bazë (departamenti) ka varësi të qënësishme nga njësitë e tjera të fakulteteve të tjera të IAL për programin master profesional, pasi një pjesë e madhe e lëndëve mbulohen prej tyre. Pavarësia e kësaj njësie do kishte impakt pozitiv në konsolidimin e programit të studimit.
8. Programi i studimit nuk paraqet kritere të vecanta pranimi për studentët që regjistrohen në këtë program.
9. Për disa lëndë specifike të programit të studimit evidentohet në programin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, mungesa e orëve praktike/laboratorike që pajisin studentët me aftësitë praktike, kjo e mbështetur me softëare përkatës.
10. Disa lëndë në strukturën mësimore si dhe në programet e tyre lëndore duhet të riemërtohen, apo dhe të rregullohen në listën e temave që ofrojnë cdo javë.
11. Literaturat bazë dhe të rekomanduara nëpër programet lëndore, në një pjesë të tyre janë më të vjetra se 5 vitet e fundit.
12. Trajnimet për studentët janë të pakta dhe që nuk lidhet drejtpërdrejt me profilin e tyre.
13. Studentët e Masterit Profesional me 5 profile kanë një përfshirje të ulët në veprimtarinë shkencore. Mungojnë kushtet lehtësuese për studentët në kryerjen e hulumtimeve shkencore.
14. Burimi kryesor i financimit të programit të studimit ngelen të ardhurat e siguruara nga tarifat për dhe gjatë shkollimit që paguajnë studentët, megjithë shtimin e burimit të financimit nga grantet e kërkimit, të cilat zënë një pjesë të vogël.

15. Nga institucioni janë bërë publike sipas Kriterit 2 të standartit VI.5, të dhënat e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit vetëm për vitet 2012-2014.
16. Mungesa e njohurive të duhura në gjuhën angleze për të konsultuar literaturën e lëndës që në këtë program studimi më së shumti është në gjuhën angleze, kufizon studentët vetëm në përdorimin e leksioneve të përgatitura në gjuhën shqipe nga lektori.

## Rekomandime

1. Njësia bazë dhe ajo kryesore duhet të rregullojnë raportet mes personelit akademik me kohë të plotë dhe numrit të studentëve, që të qëndrohet brenda kuadrove ligjore në fuqi.
2. Njësia bazë, si dhe stafi PAK dhe PAE i angazhuar në programin e studimit duhet të orientojë programin e studimit qartësisht: ose drejt përfitimit të aftësive teknike; ose atyre menaxheriale dhe proceseve të biznesit brenda profileve të vecanta. Kohëzgjatja prej një viti akademik i programit të studimit nuk i lejon të dyja. Ky orientim të shprehet qartë nëpërmjet objektivave dhe qëllimeve të programit të studimit dhe rë ruhet konsistenca në dokumenta të ndryshme.
3. IAL sugjerohet të ndërmarrë fushata rekrutimi për të përmbushur nevojat me burime njerëzore të angazhuar në lëndët e profileve te programit të studimit me natyrë teknike. Gjithashtu rekomandohen zyrat e Burimeve Njerëzore për të ndërtuar politika në lidhje me qëndrueshmërinë e stafit të drejtimeve teknike si ai i Masterit Profesional Informatikë e Aplikuar me 5 profile, që të mos ketë levizje të stafit në cdo vit akademik.
4. Njësia bazë duhet të ndërmarrë iniciativa të tjera në lidhje me aftësimin praktik te studentëve dhe përtej orëve në auditor (trajnime, certifikime, pjesëmarrje konkrete ne projekte).
5. Rekomandohet rishikimi dhe rivlerësimi i kurrikulave të secilit profil. Të përshtaten këto kurrikula jo vetëm në bazë të kërkesave të tregut vendas, apo jo vetëm në bazë të stafit që ka në dispozicion, por të konsultohen programme të ngjashme në institucione arsimore perëndimore.
6. Të përcaktohen kritere të vecanta për pranimin e studentëve në këtë program studimi, për secilin profil (mund te jene te ndryshme). Kjo në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit master, me vlerën e diplomës që synohet, si dhe me kërkesat e tregut.
7. IAL të konsolidojë dokumentacionin e kërkuar sipas kritereve të shprehur në raport, sic ato kërkohen (analizat, vendimmarrjet, verifikimet, etj), si dhe të jenë të azhornuara. Vecanërisht rekomandojmë kryerjen e Analizës Vjetore të programit të studimit në mënyrë të plotë.
8. Programet lëndore të secilit profil rekomandohen të azhornohen sipas sugjerimeve të dhëna në këtë RVJ, të përmirësohen literaturat me botime më të reja për një pjesë të lëndëve. Në përgjithësi, të rishihet struktura e profileve, si dhe të konsiderohen nevojat e studentëve për të përvetësuar më shumë pjesë praktike.
9. Institucioni të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit.
10. Të parashikohen dhe shtohen në syllabusin e disa lëndëve specifike në programin mësimor orët praktike/ laboratorike, të mbështetur me infrastrukturën e nevojshme softuer.
11. Të rishihet raporti Teori/Praktikë në shpërndarjen e krediteve për secilën lëndë dhe të përmirësohet ky raport në drejtim të Praktikës. Të ketë diferencime në këtë ndarje, pra lëndë të ndryshme brenda kategorive A, B, C të kenë raporte të ndryshme dhe jo të jenë të gjitha identike.
12. Të bëhen publike nga institucioni sipas rekomandimit, të dhënat e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit duke respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe duke u përmbajtur legjislacionit për të dhënat personale.
13. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm duhet të jetë jo vetëm në nivel institucioni por dhe në nivel programi studimi;

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master "Applied Informatics" with profiles: a) Application design and development; b) Data management; c) Security of information systems; d) Multimedia TV; e) Project Management and Evaluation, "European University of Tirana"**

**Strengths and affirmations**

1. The study program is designed in compliance with the requests for the opening of study programs that impact in the economic development of our country. The program meets the expectations of the labor market, in line with strategic goals of local and national economic development in filed of Information Technology.
2. The study program has attained decent support from management structures, which is showed by international projects, support form Labor Board, or several opportunities offered to students.
3. The institution has a consolidated system of quality control in education.
4. The convinient premises and modern didactic infrastructure available to the study program provides the required modern facilities and conditions for the education process.
5. The Increase of cooperation and participation in national and international projects has offered and supported the academic staff and students with knowledge and experience in such fields and projects in the field of study program and labor market.
6. The institution has developed specific mechanisms for the support and professional qualification of academic staff in relation to existing teaching methods, research and participation in international projects.
7. The institution has signed new mutual agreements with special focus to academic and professional cooperation in country and abroad.
8. The provision of support to students by scholarships, mobility programs, internationality for outstanding results students or participation and training in professional activities and training organized by UET and professional organizations or private companies.

**Weak Points**

1. The study program reveals ambiguity in the design of its goals and objectives. There is a lack of solidity in documentation, when are defined those important elements of the study program. These deficiencies bring to unclearness in the value of in the market for potential professions.
2. The predefined ratios for full time academic staff/student, where the academic staff should cover not less than 70 % of workload in hours, which are attained only in 2 from 5 study program profiles, respectively "Software Design and Development" and "Project Management and Assessment".
3. Full-time staffs which are engaged in teaching in three of the profiles, for technical nature courses are scarce and unstable from one academic year to the next.
4. The study program should be more consistent in the curricula within each profile, with respect to clarification to the professional competences that students should acquire.
5. Selection of profile courses is described to be in compliance with the labor market, but there is lack of approximation to similar study programs offered by international educational institutions.

6. The annual analysis documentation of the study program should be realised in whole and exhaustive, following the appropriate methodology. This would also bring to light the effects on diploma employment, curriculum building, program clarity, and so on.
7. The basic unit (department) has substantial dependence on other units residing in other faculties of UET for the professional master program, as the most part of the courses are covered by them. The independence of this unit would have a positive impact on the consolidation of the study program.
8. The study program does not present special admission criterias for students enrolled in this program.
9. For some specific courses of the study program, the curriculum and the syllabuses of the courses show the lack of practical / laboratory classes that provide students with practical skills, supported by relevant software.
10. Some subjects in study program structure, as well as in their syllabuses need to be renamed, or even arranged, in the list of topics offered each week.
11. The basic and recommended literature in the courses curricula, some of them older than the last 5 years.
12. Training for students is scarce and not directly related to their profile.
13. The students of Professional Master with 5 profiles have a low involvement in scientific activity. There are no facilitating conditions for students to conduct scientific research.
14. The main source of funding for the study program remains the income provided by the tuition for and during education tuition fees paid by students, despite the addition of a small portion of the funding for research grants.
15. The institution has published according to Criterion 2 of VI.5 standard, the study program evaluation results data for 2012-2014 only.
16. Lack of proper knowledge of English to consult the subject literature which in this study program is mostly in English, which limits students only to the use of lectures prepared in Albanian language by the lecturer.

### Recomandations

1. The basic and core units should regulate the relationship between full-time academic staff and the number of students to stay within the legal framework in place.
2. The basic unit, as well as the part time academic staff and full time academic staff engaged in the study program should orient the study program clearly: either towards the acquisition of technical skills; or managerial and business processes within individual profiles. The one-year duration of the study program does not allow for both. This orientation is clearly stated through the objectives and goals of the study program and the consistency of the various documents is maintained.
3. UET is suggested to undertake recruitment campaigns to meet the needs of human resources engaged in the subject matter profiles of the study program of a technical nature. It is also recommended that Human Resources offices develop policies regarding the sustainability of technical guidance staff such as the Professional Master of Applied Informatics with 5 profiles, so that there is no staff movement in each academic year.
4. The basic unit should undertake other initiatives related to the practical training of students and beyond the hours in the auditorium (training, certifications, and concrete project participation).
5. It is recommended to review and review the curricula of each profile. These curricula should be tailored not only to the requirements of the local market, or not only to the staff available, but to consult similar programs in Western educational institutions.

6. Specify specific admission criteria for this study program for each profile (may vary). This is in line with the goals and objectives of the master's program, the value of the degree intended, as well as the market requirements.
7. UET should consolidate the required documentation according to the criteria stated in the report, as required (analysis, decision making, verifications, etc.), and be up to date. We strongly recommend the perfom of the Annual Study of the study program in full.
8. The subject syllabuses of each profile are recommended to be updated according to the suggestions given in this report, to improve the literature with newer publications for part of the course. In general, review the structure of profiles and consider the needs of students to acquire more practical parts.
9. The institution should be committed to finding other sources of funding for the study program.
10. To anticipate and add to the syllabus of some specific subjects in the syllabus the practical / laboratory hours, supported by the necessary software infrastructure.
11. Review the Theory / Practice report on the credit allocation for each subject and improve this Practice Report. There should be differences in this division, so different subjects within categories A, B, C have different ratios and not all is identical.
12. Make available to the institution as recommended, the results of study program evaluation results respecting academic freedom and ethics and adhering to personal data legislation.
13. The involvement of external experts in internal evaluation processes should be not only at institution level but also at study program level;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT | | | X | |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | X | |